



***Ngritja e Kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Vlerësimin dhe Monitorimin e Reformimit të Sektorit të Sigurisë 2009-2011***

**Analiza e Kontekstit të  
Reformimit të Sektorit të Sigurisë  
në Kosovë  
1999-2009**

*Ky publikim është produkt i projektit rajonal "Ndërtimi i Kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Vlerësimin dhe Monitorimin e Reformes së Sektorit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor" i cili mbështetet financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Norvegjisë. Ky projekt ka karakter rajonal dhe përfshinë 7 organizata 'think-tank' te cilat vijnë nga Shqipëria, Bosna dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali Zi dhe Serbia dhe është duke u zhvilluar në bashkëpunim me DCAF ([www.dcaf.ch](http://www.dcaf.ch)). Ky punim është zhvilluar duke përdorur metodologjinë e hartuar nga Qendra e Beogradit për Politikën e Sigurisë ([www.ccmr-bg.org](http://www.ccmr-bg.org)).*

## **Përmbajtja e publikimit:**

Lista e Akronimeve .....	5
Parathënie .....	6
Hyrje .....	7
Konteksti i Sektorit të Sigurisë në Kosovë .....	10
FAZA E PARË: FILLIMI I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË SIGURISË (1999 – 2005) .....	12
Konteksti i Përgjithshëm .....	12
Analizat Institucionale .....	15
Prezenca Ushtarake Ndërkombëtare .....	15
Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) .....	16
Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) .....	17
FAZA E DYTË: TRANSFERI GRADUAL I KOMPETENCAVE TEK VENDORËT (2005 – 2008) ...	19
Konteksti i Përgjithshëm .....	19
Analizat Institucionale .....	21
Prezenca Ndërkombëtare Ushtarake .....	21
Shërbimi Policor i Kosovës .....	22
Trupat Mbrojtëse të Kosovës .....	22
FAZA E TRETË: ARKITEKTURA E RE E SIGURISË (2008 –tani) .....	24
Konteksti i përgjithshëm .....	24
Analiza Institucionale .....	25
Policia e Kosovës .....	25
Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) .....	26
EULEX .....	28
Prezenca Ndërkombëtare Ushtarake .....	28
PËRFUNDIMET .....	29
BIBLOGRAFIA .....	35
ANNEX 2 .....	37
KRONOLOGJIA E REFORMIMIT TË SEKTORIT TË SIGURISË NË KOSOVË .....	37
1 9 9 9 .....	37
2 0 0 0 .....	38

2001 .....	39
2002 .....	40
2003 .....	41
2004 .....	41
2005 .....	42
2006 .....	43
2007 .....	44
2008 .....	44
2009 .....	46
2009.....	47

## LISTA E AKRONIMEVE

AKI	Agjencia Kosovare e Inteligjencës
EULEX	BE Misioni i Sundimit të Ligjit në Kosovë
FSH	Forcat Shumëkombëshe
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GJNPJ	Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavi
GNK	Grupi Ndërkombëtar i Krizave
HRW	Human Rights Watch
IHSOP	Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Opinion Publik
IKHP	Institucioni Kosovar për Hulumtim të Politikave
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
KS-OKB	Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
MD	Ministria e Drejtësisë
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MIKB	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MUK	Monitorimi, Udhëzimi dhe Këshillimi
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
ONM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OTK	Opercioni Teknik Ushtarak
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PK	Policia e Kosovës
PNU	Prezenca Ushtarake Ndërkombëtare
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
PZHKB	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
RBSS	Rishikimi i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
RrBGH	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese
RSS	Reformimi i Sektorit të Sigurisë
SHIK	Shërbimi i Informativ së Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UCK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
ZCN	Zyra Civile Ndërkombëtare
ZHA	Zona e Hapësirës Ajrore të Sigurisë
ZTS	Zona Tokësore e Sigurisë

## PARATHËNIE

Ndjeshmëria e kontekstit të Kosovës krijon kompleksitet në relacion me Reformimin e Sektorit të Sigurisë (RSS). Procesi i tranzicionit formalisht ka filluar me mbarimin e gjendjes së luftës në vitin 1999, ndonëse periudha vijuese e menjëhershme e mbarimit të luftës është marrë kryesisht më rimëkëmbjen. Megjithatë, krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, sektori i sigurisë në Kosovë nuk ka qenë subjekt kryeput i reformimit, por më tepër kishte të bënte me ndërtimin nga themelet të këtij sektori me mbështetje të theksuar të komunitetit ndërkombëtar. Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) ishin dy institucionet kryesore të themeluara gjatë periudhës së prezencës së UNMIK-ut në Kosovë. Ndërsa prej shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë, në vitin 2008, në Kosovë është filluar me themelimin e mekanizmave të ri të sektorit të sigurisë, infrastrukturë kjo e ndërtuar në bazë të Planit të Ahtisarit për statusin final të Kosovës.

Andaj ky publikim do të fokusohet në analizën e sektorit të sigurisë në kontekst të Kosovës, fillimisht se pari do të vlerësojë periudhën e pas konfliktit dhe përpjekjet për demokratizimin dhe zhvillimin e sektorit të sigurisë (1991 – 2005); së dyti, do të vazhdojë me elaborimin e kërkesave për reformë (2005 – 2008) , dhe së fundi do të bëjë përmbledhjen e zhvillimeve të fundit në arkitekturën e re të sigurisë (2008 – prezent). Si tërësi, ky publikim është dedikuar kryesisht për analiza institucionale duke mos dhënë informacion të kompletuar mbi proceset e përgjithshme pas konfliktit dhe procesin e demokratizimit që ka ndodhur në Kosovë. Edhe pse volumi i materialit të mbledhur është i lartë, qëllimi i këtij hulumtimi nuk ka qenë vlerësimi i kërcënimeve dhe rreziqeve prezente në Kosovë, meqë kjo çështje do kërkonte vlerësim të veçantë për t'i raportuar ato në mënyrë adekuate.

Ky dokument përbën një pjesë të aktiviteteve hulumtuese të ndërmarra në kuadër të kornizës së projektit regjional , “Ndërtimi i Kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Vlerësimin dhe Monitorimin e RSS në Ballkanin Perëndimor”. Hulumtimi i bërë për qëllime të këtij dokumenti është zhvilluar gjatë periudhës Qershor – Dhjetor 2009. Duke pasur parasysh mungesën e burimeve shkencore dhe profesionale në dispozicion të këtij sektori, pritet që ky dokument të jetë burim i përshtatshëm primar për studentët, hulumtuesit, zyrtarët qeveritar dhe përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare që shprehin interesim për studim të sektorit të sigurisë.

## HYRJE

Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara (KS-OKB) miratoi Rezolutën 1244, e cila finalizoi tërheqjen e trupave jugosllave nga Kosova, po ashtu kërkoi demilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) si dhe kthimin e të gjithë të zhvendosurve në Kosovë. Rezoluta 1244 parashihte vendosjen e administratës civile të OKB-së në Kosovë të njohur si UNMIK si dhe misionin ushtarak të NATO-s me qëllim të vendosjes së paqes, rendit dhe sigurisë në Kosovë (KSKB Rezoluta, 1999). Gjatë periudhës së administratës ndërkombëtare, statusi i padefinuar politik i Kosovës bëri që sektori i sigurisë në Kosovë të mbetet prioritet i lartë për akterët ndërkombëtar. Rezoluta 1244 ishte *raison d'être* që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të kishte *kompetenca të rezervuara*<sup>1</sup> për këtë sektor të cilat vazhdoi t'i mbante deri në momentin kur Kosova shpalli pavarësinë me datën 17 Shkurt, 2008.

Periudha nëntë vjeçare nga viti 1999 deri më 2008 shënoi themelimin e Shërbimit Policor të Kosovës (ShPK)<sup>2</sup>, që u ndërtua nga themelet me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) që u themeluan si rezultat i demilitarizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), e që kishte rol të rëndësishëm posaçërisht në detyrat e mbrojtjes civile. Periudha pas konfliktit gjeti një gjyqësor të shkatërruar me infrastrukturë shumë të dobët dhe me një numër të shumë të vogël të personelit të trajnuar e të cilët më parë kanë punuar kryesisht në sistemin e mëparshëm ish Jugosllav. Sidoqoftë, siç do të elaborohet në tekst, deri në vitin 2004, pronësia lokale në sektorin e sigurisë vështirë që ishte parashtuar si çështje e ndërkohë që autoritetet e UNMIK-ut shprehën shumë pak (nëse jo aspak) gatishmëri për realizimin e konceptit. Me fjalë të tjera, ka pasur fare pak ose aspak 'zë vendor' në konsolidimin e sektorit të sigurisë.

Në fakt cikli i zhvillimit institucional si dhe fuqia ekzekutive e UNMIK-ut, në sektorin e sigurisë u sfidua seriozisht si rezultat i kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme, me theks të posaçëm në trazirat që kanë ndodhur me 17 dhe 18 Mars, 2004. Ndërkohë edhe pse mund të pranohet që trazirat e dhunshme të cilat kanë ndodhur me 17 Mars kanë pasur ndikim në zhvillimet e mëtejme të Kosovës, ato rrjedhimisht çuan në një qasje të re, që përveq tjerash, imponuan Rishikimin e Brendshëm të Sektorit të Sigurisë (RBSS, 2006), gjë që edhe u inicua bashkarisht nga UNMIK-u dhe Qeveria e Kosovës. Si pasojë, që nga atëherë nevoja për reforma është ndërlidhur me negociatat rreth statusit të Kosovës, duke u përmbyllur me krijimin e arkitekturën e re të sektorit sigurisë të paraparë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

<sup>1</sup> Përgjegjësia e rezervuar është një përkufizim i përdorur nga UNMIK-u që shënoi autoritetin ekzekutiv të PSSP-së mbi fushat kyçe në Kosovë.

<sup>2</sup> Teksti do i referohet ShPK-së (Shërbimi Policor i Kosovës), apo PK (Policia e Kosovës) i cili është i njëjti institucion, por ndryshoi emrin nga SHPK-ja në PK-së nga viti 2008. Lexuesi nuk do të ngatërrohet.

Kësisoj, duke pasur parasysh kontekstin specifik të Kosovës në lidhje me reformimin në sektorin e sigurisë, përderisa rajoni në përgjithësi mbështetet në ciklin e RSS-së, Kosova përbën një përjashtim në këtë aspekt, pasi që konteksti i saj dominohej nga karakteri themelues e ndërtues i mekanizmave të këtij sektori. Sektori i sigurisë në Kosovë ishte konstruktuar nga themelet, dhe si rezultat i një fenomeni të tillë vërehet një hendek i madh për sa i përket ndërlidhshmërisë ndërmjet institucioneve të mëhershme të ish sistemit socialist të Jugosllavisë e regjimit represiv të Milosevicit në një anë, dhe atyre të themeluara në periudhën pas mbarimit të konfliktit në anën tjetër. Për të mbështetur këtë pretendim vlen fakti se duke u nisur nga perspektiva institucionale, vetëm mekanizmat e mbrojtjes civile dhe një pjesë e gjyqësorit kanë mbetur funksionale që nga periudha para viteve 1999-ta, andaj, këto ishin të vetmit mekanizma që mund të themi se iu nënshtruan reformimit. Pavarësisht nga fakti se ndërtimi i kapaciteteve institucionale ka filluar nga 'zeroja' nevoja për ndryshimin e mentalitetit në mes ish luftëtarëve të UÇK-së dhe ish oficerëve e shërbyesve nga ish-Jugosllavia në këndvështrim të rrethanave të reja të krijuara ishte e pashmangshme.<sup>3</sup>

Duke pasur parasysh ciklin e zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë, ekipi i QKSS i ka përmbledhur këtë proces në tri faza të dallueshme. Pjesa e parë adreson periudhën prej vitit 1999 deri në fund të vitit 2005 ku autoritetet e UNMIK-ut kishin fuqi absolute mbi performancën dhe funksionalitetin e të gjitha institucioneve të sigurisë. Kjo periudhë u fokusua në masat e rimëkëmbjes dhe në përpjekjet për tejkalimin e pasojave të trashëguara si rezultat i konfliktit. Sa i përket institucioneve vendore, hulumtimi kryesisht do të koncentrohet në zhvillimin e strukturave të ShPK-së, si dhe ndodhive që kishin të bënin me TMK-në. Faza e dytë edhe pse me e shkurtër se e para, shënon hapat fillestar të transferit të kompetencave dhe reformave në institucionet e sigurisë. Më saktësisht kjo periudhë koncentrohet prej fundit të vitit 2005 deri në shpalljen e deklaratës së pavarësisë në vitin 2008. Megjithatë, në këtë periudhë edhe pse në thelb nuk ndryshohet niveli i influencimit të politikave të sigurisë nga ana e komunitetit ndërkombëtar, ndryshim cilësor mund të konsiderohet fuqizimi i rolit të Qeverisë së Kosovës dhe mekanizmave demokratik të mbikëqyrjes. Periudha e tretë shënon ekskluzivisht ndodhitë që kanë ngjarë që nga deklarata e pavarësisë në shkurt të vitit 2008 e deri në kohën e përmbylljes së draftimit të këtij hulumtimi. Kjo fazë shënon nevojën për konsolidimin e arkitekturës së re të sigurisë bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Policia e Kosovës (PK) dhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) duhet të konsiderohen si akterë kryesorë vendor të sigurisë.

Ky dokument ka për qëllim që në mënyrë kritike të vlerësojë kontekstin e zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë duke filluar prej vitit 1999. Qëllim i ekipit hulumtues nuk

<sup>3</sup> ShPK dhe TMK u përbënë pjesërisht nga ish anëtarët e UÇK-së, si dhe nga ish zyrtarë ushtarak dhe policor nga sistemi i ish Jugosllavisë.



ka qenë që në detaje të shtjellohen proceset dhe aktorët, më tepër ka qenë qëllimi që të vihen në dukje çështjet kyçe në mënyrë që lexuesi i këtij publikimi hulumtues të ketë një pamje të përgjithshme të sektorit të sigurisë në Kosovë. Ky hulumtim nuk mundi të hyjë në thellësi dhe të prek temat dhe fushën e gjyqësisë edhe pse një analizë e tillë do të kontribuonte në elaborimin e çështjeve të rëndësishme të sektorit të sigurisë në një koncept më të gjerë. Në të vërtetë, kjo analizë do të ofron vlerësim në lidhje me secilën periudhë duke ju përmbajtur edhe dinamikës socio-politike, dhe shkurtimisht do të përmenden edhe indikatorët kryesor për kërcënimet dhe rreziqet, si dhe aspekte të tjera të ndërlidhura me sektorin e sigurisë. Për shkak të situatës unike në Kosovë, deri më tani vetëm KFOR-i dhe ShPK-ja kanë pasur rolin kyç përgjatë të tri periudhave, ndërkohë që institucionet e tjera mbizotëruan vetëm gjatë një apo dy periudhave. Për këtë arsye ka qenë në interes të kësaj analize që të vlerësohet roli i KFOR-it, dhe me theks të veçantë ndikimi që ka pasur përgjatë gjithë kësaj dekade. Përveç kësaj, roli i ShPK-së është vlerësuar gjatë tri periudhave dhe reputacioni i TMK-së do të vlerësohet në mënyrë më specifike. Së fundi, duhet përmendur se Kushtetuta e Republikës së Kosovës hapi rrugën themelimit të institucioneve të reja të sigurisë. Andaj ekipi hulumtues i këtij publikimi e pa si tejet të nevojshme edhe vlerësimin e themelimit të FSK-së si dhe Misionit të BE-së për Sundim të Ligjit - EULEX.



## KONTEKSTI I SEKTORIT TË SIGURISË NË KOSOVË

Në vitin 1999, zhvillimi i sektorit të sigurisë në Kosovë është ballafaquar me dy sfida kryesore: me procesin e tejkalimit të pasojave post autoritare dhe më e rëndësishmja me procesin e marrjes së masave për rimëkëmbje në periudhën e pas konfliktit. Tërheqja e trupave Jugosllave nga Kosova ka shënuar fundin e gjendjes së luftës, megjithëse pasojat e luftës kanë qenë shumë më të mëdha nga se ato që ishin pritur. Për qëllime të kësaj analize vlen të theksohet se pas anulimit të statusit autonom të Kosovës në vitin 1989 dhe shpërbërjes së Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, institucionet e sigurisë ranë plotësisht nën kontrollin e aparatit shtetëror të Millosheviqit. Si rrjedhojë, ky regjim nuk ka ofruar siguri shtetërore qytetarëve në mënyrë efektive dhe efektive. Akoma më i dëmshëm ka qenë fakti se kjo gjendje ishte shkaktari kryesor i jo stabilitetit (*Bryden & Hanggi 2004: 15*) dhe represionit. Pra, duke pasur parasysh që sektori i sigurisë në Kosovën e pas luftës kryesisht është ndërtuar nga themelet, çfarëdo hulumtimi që është bërë para vitit 1999 nuk është përfshirë në këtë dokument.

Që nga viti 1999, Kosova ishte administruar nga Rezoluta 1244 e KS OKB, gjë e cila mundësoi vendosjen e prezencës ndërkombëtare civile dhe ushtarake në Kosovë. Në mungesë të sektorit të sigurisë, prezenca ushtarake ndërkombëtare kishte barrën e plotë për t'u ballafaquar me detyrat e rendit publik. Në vazhdim, situata e tensionuar politike dhe ajo e sigurisë parashtrroi nevojën për themelimin sa më të shpejt të strukturave policore në mënyrë që të përgjigjen ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve brendshme Kosovës të cilat mund shfaqeshin. Nga pikëpamja konceptuale, çështja e Kosovës ka pasur më shumë prerogativë për zhvillim të sektorit të sigurisë se sa për RSS. Zhvillimi i sektorit të sigurisë kryesisht merrej me rikuperimin e pasojave pas mbarimit të konfliktit të armatosur, përfshirë, shpërbërjen e formacioneve ushtarake dhe integrimin e tyre në strukturat e reja të sigurisë dhe / ose në jetën civile, si dhe pastrimin e zonave të rrezikuara nga minat e vendosura tokësore si dhe mbetjet e bombave apo raketave të pa-eksploduara (*Bryden & Hanggi 2004*), konceptim ky i cili fuqishëm përputhet me rastin e Kosovës.

Një nga brengat kryesore rreth zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë ka qenë mungesa e pronësisë vendore. Prezenca ndërkombëtare vazhdimish kishte hezitur ti transferoj përgjegjësitë në mënyrë efektive tek vendorët dhe përpjekjet e përshpejtuara për 'perëndimizimin' e sektorit të sigurisë në Kosovë nuk kanë qenë në përputhje me nivelin e demokratizimit dhe ndjeshmërinë e rrethanave në Kosovë. Ka pasur mungesë të dëgjimit të 'zërave të vendor' në zhvillimet e përgjithshme të sektorit të sigurisë. Përderisa ekspertët vendorë kishin argumentuar që komuniteti ndërkombëtar kishte mungesë të besueshmërisë në transferimin e përgjegjësisë tek vendorët (Qehaja 2004:56), argumenti i ndërkombëtarëve mbështetej tek konsolidimi i dobët i vendorëve dhe pa-aftësia e tyre



për marrjen e përgjegjësiwe". Në të vërtet, akterët vendor do të duhej përfshirë në proceset e sektorit të sigurisë që nga fillimi, në mënyrë që gradualisht të ndërtojnë kapacitetet vendore dhe të pranojnë bartjen eventuale të përgjegjësisë nga akterët ndërkombëtarë, sado i vështirë të jetë ky proces. Kosova është një shembull ku një sektor i sigurisë i imponuar nga jashtë nuk është treguar i favorshëm për reforma të qëndrueshme (Bryden & Hanggi 2004). Kjo mund të ilustruhet duke përdorur raste të veçanta ku ka pasur shpërputhje në mes teknikave policore të përdorura brenda për brenda ShPK-së. Kështu, ekspertët nga vende të ndryshme, duke prezantuar secili teknikat nga vendit prej nga vinin rrezikuan uniformizimin e standardeve brenda policisë, meqë metodat të ndryshme të zbatuara shpesh kanë qenë plotësisht në shpërputhje me njëra tjetrën (Raportet ICG: 2004 ).<sup>4</sup>

Përgjegjësitë e rezervuara të UNMIK-ut mbi sektorin e sigurisë bënë të pamundur implementimin e disa parimeve kyçe të RSS, veçanërisht kontrollin demokratik mbi institucionet e sigurisë. Sipas kornizës ligjore, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (PISG) nuk kishin as kompetenca ekzekutive e as mbikëqyrëse në raport me SHPK-në, TMK-në dhe gjyqësorin. Kjo situatë nuk ka mundësuar as efikasitet e as transparencë , gjë e cila rezultoi me mungesë të çfarëdo matjeje të volumit të performancës së sektorit të sigurisë. Për më tepër gjatë periudhës së parë, mbikëqyrja parlamentare mbi ShPK-në, TMK-në dhe institucionet tjera të sigurisë nuk ishte funksionale. Në vitin 2004, Kuvendi i Kosovës themeloi Komisionin Parlamentar për Gatishmëri Emergjente, duke ushtruar kështu mbikëqyrjen mbi shërbimet e emergjencave civile. Por kjo megjithatë nuk ka përfshirë ShPK-në apo TMK-në. Transferimi gradual i kompetencave ka rezultuar në faktorizimin e Kuvendin gjë që është konkretizuar me themelimin e Komisionit Parlamentar për Sigurisë në mënyrë që të mbikëqyrë ShPK-në dhe strukturat e tjera të sigurisë, edhe pse kjo e fundit ende ishte 'mbahej peng' nga pushteti i zgjeruar ekzekutiv i ushtruar nga PSSP-së. Në periudhën menjëherë pas pavarësisë shtrohet nevoja për konsolidimin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri. Megjithatë, ky komision nuk do të kishte mandat për mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Agjencisë Kosovare për Inteligjencë (KIA) pasi që u themeluan komisione të veçanta të mbikëqyrjes për këto dy institucione. Përgjithësisht, zhvillimi i mbikëqyrjes parlamentare mbi institucionet e sigurisë ka kaluar në tri faza: mungesa e mbikëqyrjes, mbikëqyrje e kufizuar dhe përfundimisht, tentimet për krijimin e mbikëqyrjes së plotë (KIPRED, 2008).<sup>5</sup>

<sup>4</sup> Mungesa e pronësisë lokale në zhvillimin e sektorit të sigurisë në Kosovë është një temë e veçantë që mund të trajtohet në detaje vetëm në një punim të veçantë

<sup>5</sup> Edhe procesi i konsolidimit të mbikëqyrjes parlamentare është në rrugën e njëjtë me periodizimin e hulumtimit



## FAZA E PARË: **FILLIMI I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT TË SIGURISË (1999 – 2005)**

Kjo kapitull do të shqyrtoj dinamikën e rëndësishme socio-politike të periudhës së lart-përmendur dhe do të prek shkurtimisht kërcënimet dhe rreziqet e cilat ishin paraqitur gjatë gjashtë viteve para që nga përfundimi i luftës. Konteksti i përgjithshëm është i dizajnuar duke iu referuar rolit të UNMIK-ut dhe politikave vendore në zhvillimin e sektorit të sigurisë në Kosovë. Një pjesë e veçantë e është kushtuar analizës institucionale me fokus të veçantë tek performanca e KFOR-it si dhe procesi i konsolidimit të ShPK-së dhe TMK-së.

### **Konteksti i Përgjithshëm**

Duke elaboruar procesin i cili ka zënë vend nga viti 1999 deri në vitin 2005, roli i PSSP-së ka qenë qenësor dhe kompetencat i kishte të besuara me Rezolutën 1244 e cila ia mundësoi themelimin e Shtyllës së I-rë të UNMIK-ut, që mbulonte sigurinë dhe drejtësinë (UNMIKONLINE, 2004). Si rrjedhojë, kjo bëri që kompetencat të përqendroheshin në nivelin e PSSP-së dhe UNMIK-ut. Në të vërtetë, indikacionet se ky lloj i gjendjes së "status quo-s" do të mund të ndryshonte nuk kanë qenë aq optimiste dhe praktikisht kjo strukturë mbeti e pandryshuar për nëntë vite me radhë. UNMIK-u kishte përgjegjësinë kryesore për themelimin dhe monitorimin e institucioneve vendore të sigurisë. Megjithatë, përkundër rolit të fuqishëm të luajtur nga akterët ndërkombëtar, nuk duhet nënvlerësuar ndikimin e akterëve vendorë në proceset e gjithëmbarshme.

Para së gjithash vlen të përmendet roli i partive politike, ku në njërin anë, kishte parti politike të dala nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), të tilla si Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ndërsa në anën tjetër ishte Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), një formacion më i vjetër politik që daton që nga periudhat e rezistencës paqësore, gjatë viteve 1990. PDK-ja ka qenë partia më e madhe politike që është zhvilluar nga struktura e UÇK-së. Hashim Thaqi, udhëheqësi i PDK-së paraprakisht ka qenë drejtor politik i UÇK-së dhe pas themelimit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Mars të vitit 1999, ai u emërua në pozitën e Kryeministrit.<sup>6</sup> Thaqi ishte figura kyçe në negociatat për demilitarizimin e UÇK-së dhe transferimin e saj në TMK.<sup>7</sup>

<sup>6</sup> Qeveria e Përkohshme është themeluar në bazë të Marrëveshjes së Rambujes edhe pse asnjëherë nuk u njoh ndërkombëtarisht.

<sup>7</sup> Për më shumë detaje rreth numrit të anëtarëve të UÇK-së dhe transformimin në TMK shih: GNK, Çka ndodhi me UÇK-në?, 2000



Përveç TMK-së, influencimi i tij vërehej edhe me rastin e themelimit të Shërbimit Policor të Kosovës (ShPK) dhe mekanizmave tjera të sigurisë. Prandaj, qeverisja e përkohshme, dhe më vonë PDK-ja kanë luajtur rol qenësor në procesin e rikonstruktimit të sektorit të sigurisë në Kosovë. Në këtë periudhë fillestare LDK dukej që ishte më pak dominante sa i përket sektorit të sigurisë. Megjithatë, për shkak të rezultateve të ulëta të PDK-së, në zgjedhjet e para të pas luftës, që ndodhi jo vetëm si rezultat i popullaritetit të fuqishëm të liderit të partisë së LDK-së z. Rugova, por gjithëashtu për shkak të rezultateve të PDK-së që kishte të bënte kryesisht me sjelljet e disa prej ish-luftëtarëve, shpui që LDK-ja të themelojë dhe të rikonsolidojë strukturat e saj dhe të krijojë rol të fuqishëm në të dy nivelet, në atë lokal dhe qendror. Megjithatë edhe përkundër pozicionimit të LDK-së pas zgjedhjeve të vitit 2000, dominimi i tyre në sektorin e sigurisë u zbehë në mënyrë të vazhdueshme nga pushteti dhe ndikimi i ish-luftëtarëve.

Përveç ndikimit të partive politike, edhe situata e ndjeshme politike dhe marrëdhëniet tepër të tensionuara ndëretnike kishin influencë të lartë në zhvillimin e sektorit të sigurisë në Kosovë. Ngurrimi i komunitetit serb për të qënë pjesë e institucioneve vendore të sigurisë lëkundti përpjekjet e vazhdueshme në ndërtimin e institucioneve të sigurisë, dhe për më tepër komplikoi procesin e demokratizimit. Megjithatë, siç do të analizohet në pjesën institucionale, pjesëmarja e minoriteteve dhe në veçanti ajo e komunitetit Serb në ShPK ka qënë në nivel mjaft të kënaqshëm. Në anën tjetër, përfaqësimi i komunitetit Serb në TMK ka qënë vështirë i imagjinushëm pasi që kishte në vazhdimësi reagime të fuqishme kundër këtij institucioni. Arsye për këtë ishte ndërlidhja e TMK-së me ish-UÇK-në gjë që vëshirësoi bashkëpunimin në mes të komunitetit Serb dhe TMK-së. Si pasojë besueshmëria për këtë institucion perceptohej shumë ulët nga komuniteti serb (UNDP, 2006, 2007). Përderisa komuniteti ndërkombëtar dhe institucionet vendore të sigurisë ftuan publikisht banorët serbë për tu bashkuar në TMK, këto përpjekje nuk prodhuan rezultate të prekshme. Një prej standardeve demokratike të kërkuara ndërkombëtarisht, i ashtuquajturit Standardi i 8, kërkoi konsolidimin e TMK-së duke vënë në theks të veçant përfshirjen e serbëve. Në përgjithësi, pavarësisht adresimit në vazhdueshësi të kësaj çështjeje, procesi i integritit të minoriteteve në sektorin e sigurisë në Kosovë konsiderohej si një nga sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet ky sektor.

Përveç përfshirjes në institucionet e sigurisë, prezenca e strukturave paralele të Ministrinë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe strukturave civile, ushtarake, dhe të inteligjencës së Serbisë, poashtu edhe sistemi paralel gjyqësor në zonat e banuara me serb, me fokus të veçantë në pjesën Veriore të Kosovës, (GNK 2005: 4) dobësoi influencën e Institucioneve të Përkohshme Vetë-Qeverisëse (IPVQ) dhe në veçanti atë të ShPK-së. Me fjalë të tjera, institucionet e Kosovës kishin shumë pak shtrirje në pjesën veriore të Kosovës dhe kjo ka ndikuar në dobësimin e përpjekjeve të përgjithshme për forcimin e sundimit të ligjit në tërë territorin e Kosovës.



Periudha pas konfliktit dallon një situatë të ndryshme, dhe identifikon lloje të ndryshme të rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë në nivel lokal dhe rajonal. Sa i përket kërcënimeve kyçe të jashtme, kjo fazë paraqet konfliktin në Luginën e Preshevës dhe në Maqedoni, në të dyja konfliktet ishte i përfshirë komuniteti shqiptar atje. Në fakt, këto dy konflikte kishin ndikim direkt në situatën e sigurisë në Kosovë, që i shërbeu mbajtjes së tensionuar të marrëdhënieve ndëretnike. Për më tepër mbajti kataklizmën e luftës tek popullata e Kosovës.

Ngjarjet e Marsit të vitit 2004 dëmtuan përpjektjet gjithëpërfshirëse për fuqizimin e institucioneve demokratike. Këto ngjarje u shënuan me një seri trazirash të dhunshme, të cilat filluan pas raportimit të lajmit nga mediat me titullin “tre fëmijë shqiptar ishin mbytur në lum”, në Mitrovicën Veriore. Me këtë rast fëmiu që kishte mbijetuar pohoi se ata ishin sulmuar nga fshatarët serb. Raportimi i gjerë nga mediat për këtë rast mund të konsiderohet si “pikë kthesë” për nxitjen e demonstratave të dhunshme që eksploduan anë e mbanë Kosovës. Megjithatë, ende nuk ekziston një skenar i vërtet që ofron sqarim për shkakтарin e trazirave në atë kohë. Sipas burimeve, rreth tridhjetë trazira shpërthyen në gjithë Kosovën duke përfshirë këtu më shumë se 50.000 protestues të dhunshëm (HRË, 2004: 3). Si rezultat i saj pasuan zhvendosjet e refugjatëve, posaçërisht e të atyre të komunitetit serb. Shkatërrimi i pronave private me pronarë serbe ka qenë mjaft i madhë, e në veçanti djegja e disa kishave ortodokse serbe me q’rast u dëmtua shumë trashëgimia kulturore në Kosovë. Këto trazira rezultuan me vdekjen e 19 civilëve, 11 shqiptar dhe 8 serb.

Siq do të shpjegohet në pjesën institucionale të këtij publikimi, këto ngjarje edhe një herë vërtetuan jo efikasitetin dhe kapacitetet e mangëta të UNMIK-ut dhe KFOR-it për të ndaluar demonstratat e dhunshme. Duke lënë mbrapa këto ngjarje, u pa se rishikimi i mandatit të UNMIK-ut ishte i domosdoshëm, pasi që zyrtarët e OKB-së u ballafaquan tani më me thirrjet nga anëtarët e Këshillit të Sigurimit të KB-së si dhe nga ekspertët e ndryshëm që të zvogëlohenë përmasat dhe shtrirjen e këtij misionit në dobi të vendorëve. Si rezultat i mos suksesit të shfaqur, frustrimi dhe skepticizmi për punën e UNMIK-un filloi të rritej në popullsi. Interpretimi i ngushtë që i bëri UNMIK-ut Rezolutës 1244 si dhe përgjegjësitë e rezervuara të PSSP-së paralizuan çfarëdo zhvillimi të mëtutjeshëm të institucioneve të sigurisë në Kosovë. Situata ekonomike stagnuese dhe çështjet e ndërlidhura me statusin politik të vendit ndikuan në humbje të durimit tek popullata.

Si përfundim në kontekstin e përgjithshëm të kësaj periudhe, vlenë të përmenden përpjekjet për krijimin e mekanizmave efektiv të emergjencës civile. Strukturat e emergjencave civile u reformuan me mbështetje të komunitetit ndërkombëtar duke u bërë kështu njëra prej fushave të para që iu transferua vendorëve (Korniza Kushtetuese 2001).



Përderisa ekzistone një Departament i Veçantë për Siguri Civile i cili ishte i bashkëkryesuar nga autoritetet vendore dhe ato ndërkombëtare, tani më ky departament u transferua në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike të IPVQ-së. Në vitin 2005 këto struktura u bënë objekt i planifikimit të Departamentit të Emergjencave në kuadër të MPB-së, edhe pse në shumë aspekte këto mekanizma ndërlidheshin më tepër me kompetencat e pushtetit lokal ku edhe në shumë raste parashihej ndërvartësi e drejtpërdrejt me kryetarët e komunave. Reformimi në strukturat e mbrojtjes civile, e në veçanti në Shërbimet Zjarrfikëse dhe ato të Shpëtimit, janë vlerësuar lartë nga komuniteti ndërkombëtar. Praktikisht Kosova mund të përdorej si model për reformimin e suksesshme të strukturave civile të emergjencës edhe nga vendet e tjera në rajon, si në aspektin e investimit, ashtu si edhe në aspektin e plotësimit të nevojave bashkëkohore të mbrojtjes civile (Shalimanov 2009: Obs).

### **Analizat Institucionale**

Kjo pjesë vlerëson balancin dhe performancën institucionale gjatë periudhës 1999-2005 në Kosovë. Përgjatë kësaj periudhe, KFOR-i ruajti përgjegjësinë për 'sigurinë e fortë' dhe me këtë ishte më dominuesi në këtë sektor. Sa i përket institucioneve vendore të sigurisë, kjo periudhë shënon themelimin e ShPK-së dhe TMK-së si dhe ngritjen e dhe zhvillimin e rolit të tyre.

### **Prezenca Ushtarake Ndërkombëtare**

Që nga vendosja e misionit në vitin 1999 nën Marrëveshjen e Kumanovës forca ushtarake paqëruajëse e udhëhequr nga NATO kishte një prezencë dinamike dhe rol udhëheqës në çështjet e sigurisë dhe ato të mbrojtjes, duke u imponuar ndër akterët kryesorë në këtë sektor. KFOR-i në kuadër të kapaciteteve të tij, i ka ofruar mbështetje popullsatës lokale gjithëashtu ka ushtruar funksione policore dhe të kontrollit të kufijve në zonat delikate, ndër më kritike nga to ishte zona në Veri të lumit Ibër pasi që autoritetet qeveritare në Kosovë kishin qasje dhe influencim të limituar atje. (GNK, 2005: 6).

Objektivi kryesor i KFOR-it në Kosovë ishte të ndalonte katastrofën humanitare pas përfundimit të fushatës së bombardimeve ajrore 78 ditëshe të NATO-s që detyroi tërheqjen e forcave serbe demilitarizimin e UÇK-së dhe të sigurojë territorin e Kosovës. Mandati i KFOR-it rrjedhi nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe nga Marrëveshja Teknike - Ushtarake e Kumanovës (MTU) në mes të NATO-s, Serbisë (Republikës Federale të Jugosllavisë) (RFJ). NATO ka qenë institucioni i vetëm kompetent për mbikëqyrjen e





marrëveshjes teknike si dhe me Zonës Tokësore të Sigurisë (ZTS) dhe Zonës Ajrore të Sigurisë (ZAS) me Serbinë.<sup>8</sup>

Deri në vitin 2002, me objektivat primare të arritura në terren, filloj reduktimi i parë i pranisë së kësaj force ku personeli ekzistues prej 45,000 pjesarësh kjo forcë u zvogëluar në 39,000, ndërsa ambienti gjithnjë e më i sigurt mundësoi reduktimin e tyre të serishëm në gjithsejt 17,500 pjesëtar deri në fund të vitit 2003, nën procesin e 'normalizimit'. Megjithatë, lëkundja e paqes dhe stabilitetit që ndodhi gjatë trazirave të Marsit të vitit 2004 e ekspozoi KFOR-in si një 'tigër' në letër (GNK 2004: 16, 17), duke nënvizuar kështu dobësi të mëdha brenda zinxhirit komandues të tij. Demonstratat shpiten vendin në drejtim të një nivel të dhunës të paparë që nga viti 1999, ku deri më 17 Mars kishte rezultuar me gjithsejt 19 njerëz të vrarë dhe qindra të plagosur, siç edhe u argumentuar më lartë. Megjithatë, shtrohet pyetja pse KFOR-i dështoi në mbrojtjen e qytetarëve, në veçanti komunitetit Serb, dhe nuk arriti të shuaj intensitetin e dhunës etnike? Në të vërtetë, përderisa janë koncipuar disa argumente të cilat i përgjigjen kësaj pyetje, më e shquara është deklarata e ish zëvendës sekretarit të Shteteve të Bashkuara, Nicholas Burns, i cili pranoi se gjatë dhunës "aftësia e kufizuar e trupave që të operojnë vetëm nën komandantin e NATO-s, dhe me aprovim të qeverive përkatëse bëri që një numër i madh i trupave të kësaj force të mbetën në kazernat e tyre".<sup>9</sup> Këto vështirësi në vendim-marrje kanë shkaktuar probleme serioze për KFOR-in gjatë përballjes me këto protesta të këtij formati dhe me karakter të dhunshëm.

### **Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK)**

Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) duhet të konsiderohen si një nga akterët kryesorë vendorë gjatë periudhës së parë dhe në fakt ishin në krye të axhendës politike vendore. TMK u themelua si organizatë civile emergjente, duke rekrutuar 3,052 pjesëtarë aktiv profesional dhe 2000 rezervistë. TMK ishte e përbërë kryesisht nga ish anëtarët e UÇK-së nën mbikqyrje të rreptë nga KFOR-i dhe Zyra Koordinuese e UNMIK-ut për TMK. Ajo ishte modeluar në bazë të modelit Francez të Sécurité Civile ku mandati i saj parashikonte kryerjen e detyrave të gatishmërisë emergjente; ofrimin e ndihmës në rast të katastrofave natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri, deminimin e zonave të minuara, detyrat ceremoniale dhe ofrimin e ndihmës humanitare. Trajnimet fillimisht u bënë nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), përcjellë nga KFOR-i, UNMIK-u dhe akterët e tjerë.

<sup>8</sup> Zona e Sigurisë Ajrore është përcaktuar si një zone 25 kilometrëshe që shtrihet përtej kufirit të Kosovës në pjesën tjetër të territorit të RFJ-së. Ajo përfshinë hapsirën ajrore 25 kilometrëshe mbi këtë zonë. Zona e Sigurisë tokësore (ZST) është përcaktuar si një zone 5 kilometrëshe që shtrihet përtej kufirit të Kosovës në pjesën tjetër të territorit të RFJ-së. E përfshinë terrenin brenda zones 5 kilometrëshe. Për më tepër detaje shih Marrëveshjen e Kumanovës: <http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>

<sup>9</sup> Shih fjalimin e Nicholas Burns, Zëvendës Sekretari i Shtetit ShBA, [http://riga.usembassy.gov/EN/site/Z/a\\_nato/archive/nato20061122\\_2](http://riga.usembassy.gov/EN/site/Z/a_nato/archive/nato20061122_2)





Edhe pse korniza ligjore ka dhënë vetëm disa detyra të limituara, opinioni publik në atë kohë tregoi se TMK ishte institucioni më i besuar në Kosovë <sup>10</sup> (UNDP, 2006), dhe krahasuar me institucionet tjera publike, në vazhdimësi mbeti një prej institucioneve më të besuara, së bashku me KFOR-in dhe SHPK-në. Bazuar në perceptimet e përgjithshme të publikut kjo trupër përfaqësonte ndjenjën e institucionit të “uniformuar” dhe si para-ardhësitë e UÇK-së mbante gjallë shpresat për transferimin e saj në një të ardhme në Ushtrinë e Kosovës.<sup>11</sup> Madje edhe disa zyrtarë të UNMIK-ut dhe KFOR-it pranuan (edhe pse asnjëherë si prononcim zyrtar) se TMK ishte një organizatë e stilit ushtarak (ICG, 2000: 11). Eprorët e lartë të TMK-së dukej se ishin të mjaft influencues dhe reagimet e tyre në raste specifike ishin trajtuar si kërkesa serioze si nga komuniteti ndërkombëtar po ashtu edhe nga institucionet qeverisëse vendore. TMK mori pjesë në parada ceremoniale të ndryshme ku prezenca e tyre në aktivitete të sigurisë bënë që ajo të trajtohet ndër akterët kryesor të asaj kohe. TMK ishte ndër institucionet e para që përmbushën standardet e kërkuara ndërkombëtarisht dhe një pjesë e caktuar e zyrtarëve të lartë ishin vlerësuar lartë për fushatë të drejtë në përfshirjen e komunitetit serb dhe minoriteteve në TMK. (RBSS, 2006).

Për shkak të përgjegjësive të rezervuara të PSSP-së mbi TMK-në, gjatë periudhës së funksionimit të këtij institucioni asnjë aktivitet për mbikqyrjen e jashtme të tij nuk ishte ndërmarrë. Autoritetet e UNMIK-ut tentuan të minimizojnë rolin e TMK-së duke përjashtuar mundësinë e kontrollit demokratik apo edhe mbikqyrjen e drejtpërdrejt nga ana e Qeverisë. Kjo bëri që mbikqyrja e këtij institucioni të jetë unike. Për më tepër, Komisioni Parlamentar për Gatishmëri Emergjente dhe pasuesi i tij Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri ushtruan kompetencë shumë të limituar në mbikqyrjen e TMK-së, duke dobësuar kështu çfarëdo përpjekje për kontroll demokratik. Sa i përket mbikqyrjes nga ana e mediave, perceptimi i përgjithshëm pozitiv bëri që TMK të jetë ‘imune’ para kritikave të mediave. Madje edhe në rastet e korrupsionit, të zbuluara si rezultat i raporteve të auditimit u transmetuan me një tonë befasi nga mediat, që publikuan incidentin si diçka që nuk është pritur të ndodh nga ata (Gazeta ditore ‘Express’, 2007).

### **Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK)**

Themelimi i SHPK-së shënon fillimin e ndërtimit të kapaciteteve të sektorit të sigurisë në Kosovë dhe ky mekanizëm përfaqëson institucionin më të rëndësishëm të sigurisë të krijuar deri më datën kur është shkruar ky publikim. Si institucion tërësisht i ri, ShPK, u themelua në Shtator të vitit 1999 me trajnim të ofruar nga OSBE e cila mbështeti iniciimin e

<sup>10</sup> Por kjo nuk vlen për komunitetin Serb, duke qenë se ata shfaqin mosbesim ndaj këtij institucioni duke e ndërlidhur atë me ish UÇK.

<sup>11</sup> Ky është një rast i ngjashëm me vendet ish Jugosllve ku ushtria luajti një rol imperial në shoqëri. Edhe pse TMK nuk ishte ushtri, ndjesia e perceptimit të saj si armatë e ardhshme e Kosovës e kishtë bërë këtë perceptim të fuqishëm. TMK këtë institucion e konsideronte ushtri.



ndërtimit të një qendrës së trajnimit në Vushtrri. OSBE-ja dhe UNMIK u ndërtuan strukturat e SHPK-së brenda një periudhe shumë të shkurtër, në mënyrë që kjo organizatë të marrë pjesë në operacionet e sundimit të rendit dhe ligjit. ShPK ja arriti të ndërtoj kapacitetet saja themelore duke ndërtuar strukturat e saj dhe rekrutuar personelin e saj në kuota gjithëpërfshirëse përshirë këtu përfaqësim dinjitoz të grupeve etnike. Në kohën kur u themelua,, ky institucion ishte mjaft multnietnik me 12 deri 15% zyrtarë nga komunitetet minoritare. Fushata e informimit për të tërhequr grupet e grave dhe ato minoritare, si dhe puna e komunitetit ndërkombtar e zhvilluar në terren kishte inkurajuar këto grupe që të përfshiheshin në ShPK. Përveç kësaj, ekonomia e dobët dhe mundësitë e kufizuara për punë kishin ndikuar që këto grupe t'i bashkoheshin ShPK-së.

Në dimensionin operacional, ShPK kishte filluar të funksionoj në bashkëpunim me KFOR-in si dhe policinë e UNMIK-ut. Roli i KFOR ishte krejtësisht përkrahës duke u reduktuar gjatë kalimit të kohës dhe duke ja kaluar kështu detyrat policore ShPK-së dhe Policisë së UNMIK-ut, ndërkohë që situata e sigurisë përmirësohej vazhdimisht. Roli i UNMIK-ut ishte shumë më tepër autokratik, duke e bërë ShPK-në subjekt të kontrollit të hollësishëm, ndërsa mbante rolë të gjerë në drejtimin, kontrollin, trajnimin dhe monitorimin e SHPK-së. Pavarësisht nga ajo se ky kontroll ishte i nevojshëm sidomos gjatë periudhës fillestare, më pas një gjë e tillë ndikoi që zhvillimet pozitive që ndodhën në ShPK të kishin impakt shumë të vogël në ndryshimin e çasjes së policisë së UNMIK-ut nga mandati fillestar që kishte. (UNMIKONLINE 2004).

Gjatë kësaj periudhe, kontrolli demokratik ishte i paqartë. Shoqëria civile kishte pak ose pothuaj aspak çasje në monitorimin e operacionalitetit dhe funksionimit të ShPK-së. Madje edhe Kuvendi të Kosovës i mungonin kompetencat për mbikqyrjen e këtij mekanizmi zbatuesues të ligjit duke pamundësuar mbikqyrjen demokratike në fillet e konsolidimit institucional të policisë. Këto vështirësi ndikuan në impotencën e institucioneve vendore të sigurisë në Kosovë për t'u marrë me situata potencialisht të rënda dhe me rrezik potencial, siç ishte ajo e Marsit 2004, ngjarje kjo ku institucionet dështuan të ofronin një zgjidhje për qetësim të situatës. Përveç këtyre sfidave dhe mangësive, ShPK kishte arritur që të fitojë besimin e qytetarëve në përgjithësi, duke u ranguar në mesin e dy institucioneve më të besuara në vend.

Për shembull, në periudhën Janar 2005 – Dhjetor 2006, trendi i besimit në ShPK varioi ndërmjet 86% dhe 81%, ndërsa krahasimisht, besimi kundrejt PSSP-së, UNMIK-ut dhe IPVQ-së kishte pësuar rënie nga 81% në 34% dhe më pas në 24% (Raporti i Paralajmrimin të Hershëm, 2005, 2006). Me fjalë të tjera, besimi i publikut ndaj ShPK-së ishte mjaft i qëndrueshëm krahasuar me perceptimin publik relativisht të ulët për Qeverinë e Kosovës dhe praninë civile ndërkombëtare.



## FAZA E DYTË: TRANSFERI GRADUAL I KOMPETENCAVE TEK VENDORËT (2005 – 2008)

Në këtë pjesë do të elaborohen zhvillimet kryesore politike të cilat kishin ndikim në zhvillimin e sektorit të sigurisë dhe në veçanti, roli i akterëve jo – statutorë të sigurisë. Do të elaborohet po ashtu procesi i rishikimit të brendshëm të sektorit të sigurisë. Ndërsa roli i KFOR-it, ShPK-së dhe TMK-së në këtë periudhë do të vlerësohet në pjesën institucionale.

### Konteksti i Përgjithshëm

Me kërkesë të Qeverisë së Kosovës dhe UNMIK-ut, Rishikimi i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë (RBSS)<sup>12</sup> filloi në fund të vitit 2005, duke shënuar hapat e parë drejt ndryshimeve pasi përcaktoi rekomandimet që do merren në konsideratë për transferin gradual të përgjegjësive. Ky hulumtim i gjerë dhe gjithëpërfshirës ka indentifikuar magësitë në funksionimin e mekanizmave UNMIK-ut për siguri. Për më tepër, hulumtimet për RBSS përputheshin me periudhën e negociatave për statusin final të Kosovës andaj siç mund të vërehet tëpaktën një pjesë e rekomandimeve të dala nga ky raport u përfshinë edhe në Planin e Ahtisaarit.

Nga nëntori i vitit 2005, Sekretari i Përgjithshëm i KB emëroi Kai Aide si përfaqësues special të OKB-së për rishikimin e përgjithshëm të gjendjës në Kosovë, i cili lansoi raportin e ashtu quajturave “Standardet para Statusit” i cili do të duhej të implementohej nga ana e IPVQ-ve. Z. Aide arriti në përfundim se, “përderisa zbatimi i standardeve në Kosovë kanë qënë jo i kënaqëshëm, ka ardhur koha që të lëvizet në drejtim të definimit të procesit politik” (Raporti i Kai Aide, 2005). Ky raport hapi negociatat për statusin përfundimtar të Kosovës duke hyre në një periudhë të re politike.

Nga një perspektivë institucionale, një vije e hollë ndan periudhën e parë prej të dytës, dhe nuk ka ndryshime rrënjësore me përjashtim të themelimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministrisë së Drejtësisë (MD). Sodoçoftë, rëndësi ka që periudha e dytë e shënoi fillimin e transferimit të përgjegjësive tek vendorët. Në vecanti institucionet vendore, ishin bërë më të fuqishme. Në këtë mënyrë, periudha e dytë ishte ‘urë’ ndërlihdhëse në mes të periudhës së parë dhe të tretë duke potencuar aftësitë e vendorëve për të marr përsipër përgjegjësitë në sektorin e sigurisë.<sup>13</sup> Edhe pse nuk është

<sup>12</sup> Rishikimi i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë (RBSS) në Kosovë është inicuar nga Qeveria e Kosovës dhe UNMIK-u në vitin 2005 për të bërë një vision të situatës së brendshme të sigurisë. Programi i RBSS në Kosovë është ndërtuar për bërë vlerësime të kërcënimeve të bazuara në konsultime publike më të gjëra në rishikimin e sektorit të sigurisë.

<sup>13</sup> Është me rëndësi të përmendet që sfidat politike dhe të sigurisë të vitit 2006 lidheshin me vdekjen e presidentit historik të Kosovës Z. Ibrahim Rugova. Kishte frikë nga rritja e pasigurisë politike për shkak të përplasjeve ndërmjet partive politike në politiken vendore në Kosovë. Për më shumë, vdekja e Rugovës ndoshi në fillim të negociatave për statusin përfundimtar të Kosovës dhe për përpjekjet e para për kalimin gradual të kompetencave te vendorët.



në fokus të këtij dokumenti, periudha e dytë në një masë shënon përfshirjen e IPVQ-ve në punë të jashtme. Në vecanti, “diplomacia lëvizëse” e Kryeministrit dhe Presidentit ma qëllime të avokimit para dhe gjatë negociatave për statusin përfundimtar të Kosovës kishin sfiduar kompetencat e PSSP-së në këtë pikë. Në lidhje me negociatat për statusin final të Kosovës, ato përfunduan me paraqitjen e propozimit për statusin final nga ana e Ahtisarit në fillim të vitit 2007, e cili i në bazë të këtij propozimi i dha Kosovës pavarësi të mbikëqyrur. Pjesë e këtij propozimi që i referohet sektorit të sigurisë, u përfshi edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe kishte paraparë krijimin e institucioneve të reja sigurisë dhe po ashtu reformim të nevojshëm të sistemeve aktuale.

Kjo periudhe shënon më tepër një lloj rreziku të karakterit politik, lidhur me fatin e statusit përfundimtar të Kosovës. Sikurse u shpjegua më lart, procesi i negociatave politike reflektoi në situatën e sigurisë në Kosovë duke e mbajtur situatën jostabile. Kjo ishte demonstruar nga protestat e dhunshme të lëvizjeve lokale siç ishte “Vetvendosja”<sup>14</sup>, e cila haptazi kishte kundërshtuar çfarëdo negociate apo zgjidhje përpos asaj të arritur me ushtrimin e të drejtës së vetvendosjes nga ana e qytetarëve të Kosovës. Megjithate, krahasuar me periudhen e pas konfliktit, sondazhet tregojnë se kërcënimet kryesore të sigurisë së brendshme të Kosovës ishin çështjet që kishin të bënin me pasiguri ekonomike siç ishin: niveli i lartë i papunësisë, zhvillimi i ngadalësuar ekonomik si dhe korrupsioni (RBSS 2006) duke zëvendësuar rreziqet dhe kërcënimet që tradicionalisht kishin brengosur qytetarët e Kosovës.

Nëse shikohet skena politike, në fillim qeveria e re e Kosovës u themelua në bazë të koalicionin pas-zgjedhor të lidhur ndërmjet LDK-së dhe AAK-së dhe duke e lënë kështu PDK-në jashtë qeverisë në kapacitet të partisë më të madhe opozitare në Kosovë. Përkushtimi i LDK-së për të mbajtur Presidencën i kishte mundësuar AAK-së që të marr pozitën e Kryeministrit, edhe pse në zgjedhje kjo parti kishte fituar vetëm 7% të elektoratit. Prosesi i kalimit të përgjegjësisë në sektorin e sigurisë i bënë AAK-në dhe LDK-në parti udhëheqëse në procesin e themelimit të MPB-së dhe MD-së. Unifikimi i qëndrimeve ndërmjet partive politike në pushtet si dhe atyre opozitare është perceptuar si një qasje e përbashkët strategjike e cila shpiu drejt pavarësisë së Kosovës. Kjo qasje parandaloi rrezikun potenciale për krizë qeveritare, duke ruajtur kështu artificialisht stabilitetin politik.

Poashtu është me rëndësi të përmenden aktivitetet e strukturat jo-statutare të sigurisë në Kosovë. Në fakt, strukturat jo-statutare kanë ekzistuar që nga fillimi i periudhës së pas-konfliktit në Kosovë, megjithatë, disa raste që kishin ndodhur gjatë vitit 2005 dhe 2006 kishin shpalosur ekzistencën e së paku dy shërbimeve jo-statutare partiake të

<sup>14</sup> Për më tepër detaje për Vetëvendosjen, shih <http://www.vetevendosje.org/>



inteligjencës. I pari ishte Shërbimi Informativ i Kosovës (ShIK-u)<sup>15</sup> -, i ndërlidhur me PDK-në dhe i themeluar gjatë luftës nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës. Dhe i dyti, Instituti për Hulumtime Strategjike dhe të Opinioneve Publik (IHSOP) i ndërlidhur me LDK-në. Roli i tyre kryesor ishte të mbledhin informacione, bëra e analizave, zakonisht për nevoja të partive politike por edhe të grupeve apo individëve tjerë. Sipas pretendimeve të shefit të ShIK-ut, kjo organizatë kishte përformuar në përputhje me shërbimin e inteligjencës duke plotësuar zbrazësirën e shfaqur në raste të caktuara në dobi të së, 'mirës kombëtare dhe publike' (Veseli, 2009: cituar). Duke pasur parasysh marrëdhëniet e ngushta të këtyre organizatave me partitë politike përkatëse, vështirë do ishte të besohet që ShIK dhe IHSOP nuk kishin ndikim në vendim-marrjen e akterëve përkatës politik. Për të përmbledhur gjithë këtë, roli i strukturave jo statutare të sigurisë kishte qenë në masë të madhe kontradiktor.

### **Analizat Institucionale**

Kjo periudhë vënë në theksë ndryshime për sa i përket dominimit tek institucionet e sigurisë. Fillimi i bartjes së përgjegjësisë si dhe themelimi i MPB automatikisht ngitën performancën e ShPK-së si dhe shtoi rolin e saj dominues . Ndërkohë që prezenca e konsiderueshme e KFOR-it dhe roli i dukshëm i tij gjatë negociatave për statusin final të Kosovës ndikuan që kjo organizatë të mbetet edhe më tutje një nga akterët kryesor ndërkombëtar. Po ashtu TMK vazhdoi të demonstroj rolin e rëndësishëm të saj.

### **Prezenca Ndërkombëtare Ushtarake**

Zhvillimet e reja në Kosovë shtynë KFOR-in që t'i përshtatej rrethanave të reja të krijuara. Në këtë mënyrë, KFOR-i iu kishte nënshtruar ndryshimeve thelbësore, duke u kthyer nga Brigada Ndërkombëtare 'statike' në pesë Ekipa Vepruese Shumëkombëshe (TFShK)<sup>16</sup> dhe ky proces tranzicioni kishte për qëllim përmirësimin e efektivitetit të forcave si dhe përmirësimin e operimit fleksibil në gjithë territorin e Kosovës, pa ndonjë kufizim. Për më tepër, kjo forcë u fokusua në të ashtu quajturat 'operacione të udhëhequra nga inteligjenca' ku në bashkëpunim të ngushtë me TFShK-të u koncentrua në mbledhje të informacioneve lidhur me policinë dhe popullatën e vendit. Përgjatë negociatave të vitit 2007/2008, KFOR-i kishte përkrahur përpjekjet e Planit të Ahtisaar-it si dhe kishte ndihmuar në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në terren, duke mundësuar kështu që negociatat të zhvillohen pa ndonjë pengesë. Pavarësisht frikës nga ndonjë shpërthim, vetëm demonstrata të shkallës së vogël ishin regjistruar.

<sup>15</sup> Shërbimi Informativ i Kosovës

<sup>16</sup> Arkitektura e re e pranisë së KFOR-it në Kosovë ishte ndarë në pesë forca shumëkombëshe: Forca Shumë Kombëshe me qendër në Lipjan, MNTF Veriu me qendër në Novo Selo, MNTF Jug me qendër në Prizren, MNTF Perëndimi me qendër në Pejë/Pec, MNTF Lindja me qendër në Ferizaj/Uroševac



## Shërbimi Policor i Kosovës

Gjatë vitit 2006, akterët relevant në Kosovë u pajtuan që ShPK duhet të jetë subjekt i zhvillimit të mëtutjeshëm dhe si rrjedhojë duke i zgjeruar kompetencat e saj. Brenda ShPK-së strukturat e reja dhe njësitë e posakrijuara, siç janë policimi në komunitet, si dhe mekanizmat lokale të sigurisë kishin për qëllim të siguronin përmirësimin e shërbimeve të sigurisë për qytetarët e vendit. ShPK përvetësoi përgjegjësi të bartura nga Policia e UNMIK e cila bëri që kjo forcë të punoj si e pavarur, duke e ngritur nevojën e kontrollit civil dhe demokratik të organizuar në kuadër të MPB-së.<sup>17</sup> Me kalimin e përgjegjësisive tek ShPK-ja, mbikëqyrja civile dhe demokratike edhe pse e dobët kishte filluar të funksionalizohej. Çfarë është mëse rëndësishme, vetë themelimi i MPB-së gjatë kësaj kohe ndikoj në ushtrimin e kontrollit civil të ShPK -së. MPB ishte fillimisht një institucion relativisht i vogël i përbërë nga një numër i vogël departamentesh. Megjithatë, brenda një periudhe të caktuar kohore, kjo ministri u zgjerua duke përfshirë pothuajse numrin më të madh të shërbyesve civil krahasuar me ministritë tjera, madje duke mbajtur më shumë të punësuar se sa numri i të punësuarve në ministritë përkatëse të pesë vende të tjera Bashkimit Evropian (FRIDOM, 2009: 20).<sup>18</sup>

## Trupat Mbrojtëse të Kosovës

Dominimi i TMK mbeti i lartë, kjo për shkak të opinionit vendor në lidhje me nevojën e transformimit të saj në Forcën Mbrojtëse të Kosovës, apo së paku për transferim gradual të disa kompetencave të sigurisë në drejtim të këtij institucioni (ISSR 2006). Në fakt, sikurse shpjegohet më lartë, struktura dhe zinxhiri komandues i TMK-së konsiderohej të ishte në përputhje me ushtritë e shteteve tjera (ISSR, 2006). Megjithatë, mandati i saj ishte i limituar vetëm në detyrat emergjente dhe ato civile si dhe 'status quo'-ja ekzistues ndikuan që TMK-në të vlersohet si forcë, pa ndonjë vizion të qartë përfshirë këtu mungesën e dinamizmit, veçanërisht nga viti 2007. Deri më tani, TMK ka qenë drejtpërdrejt e përfshirë në disa raste të reagimeve emergjente, sikurse ishin tërmeti në Gjilan, vërshimet, misionet e shpëtimit dhe rindërtimit. Megjithatë, kjo forcë ishte e kufizuar që ti ndihmonte mekanizmat tjerë të zbatimit të ligjit dhe në detyrat që ishin më tepër të ndërlidhura me rendin dhe sigurinë.

Kjo periudhë shpalosi një mori mangësish, të cilat për rrjedhojë kishin ngritur kërkesën për reformim të këtij institucioni të sapo themeluar. Së pari, ndikimi i një numëri të

<sup>17</sup> Një prej mekanizmave kryesor të mbikëqyrjes është Inspektorati i Policisë së Kosovës – një trup civil i krijuar që të kontrolloj dhe mbikëqyrë efikasitetin e policisë si dhe të hetoj çfarëdo shkelje të mundshme nga ana e saj.

<sup>18</sup> Hulumtimi i ndërmarrë nga FRIDOM tregon që, të themi në krahasim me vende tjera, MPB e Kosovës është me e madhe se pesë prej gjashtë institucioneve tjera të disa vendeve të BE-së (me popullatë): Estonia, Slovenia, Lithuania, Latvia and Finlanda.



caktuar i individëve (zyrtar të lartë të TMK-së) ishte i konsiderueshëm në rajonet prej nga vijnë ata. Veçanërisht në periudhën e pas konfliktit kjo kishte shkaktuar ndarje dhe deri në një masë caktuar kishte ndikuar negativisht në performancën e TMK-së. Kishte shumë personel me grada të larta ushtarake, duke krijuar strukturë ilustrative si atë të “dardhës kokëposhtë”. Për më shumë, në disa situata kyçe, zyrtaret e lartë të TMK-së haptazi refuzuan t’i nënshtroheshin urdhrave të kolonelëve të tyre, kjo për shkak të bindjeve të tyre personale apo përkatësisë<sup>19</sup> grupore. Këto ndasi brenda TMK-së, tërhoqën vëmendjen në radhë të parë të bashkësisë ndërkombëtare ku në disa raste marrëdhëniet ndërmjet disa anëtarëve të cakuar të TMK-së dhe KFOR-it ishin shumë të tendosura (James, 2003: 5). Plani i Ahisaari-t (2007) parashihte ‘shpërbërjen me dinjitet’ të TMK-së, ndërkohë që pakënaqësitë ndaj këtij propozimi shpreheshin nëpërmjet medimeve, ku përveç tjerash raportohej edhe për protesta të dhunshme megjithse me një intensitet të ulët. Pakënaqësia kishte shpërthyer sidomos gjatë Janarit dhe Shkurtit të vitit 2009, kur një grup ish pjesëtarëve të TMK-së nuk kishte kaluar vlerësimin e KFOR-it për t’u rekrutuar për FSK, ndërkohë një pjesë e tyre ishin de-graduar.

<sup>19</sup> Gjatë ceremonisë mortore të Presidentit të Kosovës më 2006, Komandanti i Rojes së TMK-së, Gjenerali Nuredin Lushtaku refuzoi t’i nënshtrohet urdhrave të Gjeneralit të TMK-së Agim Ceku për të angazhuar grupin ceremonial në ceremonisë mortore.





## FAZA E TRETË: **ARKITEKTURA E RE E SIGURISË (2008 –TANI)**

Kjo pjesë do të analizoj zhvillimet kryesore në periudhen pas pavarësisë. Do nxjerret në pah arkitektura e re e sigurisë e 'ngulitur' në kornizen ligjore. Pjesa institucionale do të prek rolin e KFOR-it dhe PK-së, misionin e EULEX-it të vendosur së fundi dhe FSK-në në zhvillim.

### **Konteksti i përgjithshëm**

Që prej shpalljes së deklaratës së pavarësisë më 17 Shkurt 2008, korniza ligjore lejon kompletimin e infrastrukturës së sektorit të sigurisë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e Kosovës. Sipas Kushtetutës, "Republika e Kosovës ka pushtet mbi zbatimin e ligjit, sigurinë, drejtësinë, sigurinë publike, inteligjencën, organet civile emergjente dhe mbi kontrollin e kufijve në territorin e saj" (Kushtetuta 2008: Art. 125). E thënë më thjesht, sektori i sigurisë ishte bërë pjesë e përgjegjësisë për qeverinë e Kosovës. Megjithatë, roli i EULEX-it për sa i përket çështjeve të sigurisë dhe mandati paqe-ruajtës dhe paqendërtues i KFOR-it ishte pranuar gjerësisht. Themelimi i Zyrës Civile Ndërkombëtare (ZCN), në kapacitetet e 'kujdestarit' për mbikqyrjen e zbatimit të zgjidhjes së përkohshme të Ahtisaar-it, mban autoritetin për të ndërhyrë në rast të ndryshimeve apo thënë më konkretisht mospërputhjeve në zhvillimin e sektorit të sigurisë. Sektori i drejtësisë mbetet një nga sektorët më të dobët edhe në periudhën e pas-pavarësisë (EULEX, 2009: 4). Pavarësisht përpjekjeve në rritje të bashkësisë ndërkombëtare, deri më sot rezultatet mbeten të limituara, duke e mbajtur publikun të pakënaqur me drejtësinë (BIRN, 2009: 8).

Qeveria e Kosovës është në fazën e hershme të zhvillimit të politikave të sigurisë, ku përjashtim duhet bërë tek politikat e mbrojtjes, të cilat ende nuk parashihen me Kushtetutë. Aktualisht, me përjashtim të KFOR-it asnjë nga institucionet e sigurisë nuk është i destinuar që të kryej detyra të mbrojtjes. Duke analizuar kornizën aktuale ligjore dhe zhvillimin e saj, është evidente që sektori i sigurisë në Kosovë duhet të fokusohet në ruajtjen e sigurisë publike dhe të drejtat e qytetarëve në Kosovë, në përputhje me kërkesat për krijimin e Kosovës si shoqëri diverze dhe multietnike. Në krahasim me dy periudhat e kaluara, korniza ligjore parasheh kontroll demokratik më të 'fuqishëm' mbi institucionet e sigurisë (Kushtetuta, 2008,). Megjithatë është ende tepër herët të vlerësohen rezultatet konkrete në lidhje me këtë.

Krahasuar me periudhat e kaluara, pushteti i partive politike në këtë sektor u fuqizua paralelisht me zbehjen e dominimit të jashtëm. Skena politike në masë të madhe është ndikuar nga PDK-ja, e cila në zgjedhjet e fundit të vitit 2007 ishte bërë partia më e madhe në Kosovë. Si e tillë, qeverisja e cila u krijua nga kjo parti ishte më e rëndësishmja që nga periudha e pas-konfliktit, dhe prandaj, diskursi i stabilitetit politik ishte arsyeja që





ish kundërshtaret e vjetër – PDK dhe LDK – të lidhin koalicion qeverisës së bashku. Koalicioni, i përbërë nga dy partitë kryesore ishte kritikuar gjerësisht si artificial, dhe për rrjedhojë skena politike kishte rezultuar në një opozitë relativisht të dobët. Për më shumë, PDK kishte ushtruar pothuajse një supremaci absolute në krahasim me partnerin e saj, duke mënjanuar çdo përpjekje për ‘kontroll të përbashkët’ të zhvillimit dhe reformimit të sektorit të sigurisë në Kosovë. Në fakt, PDK kishte dominuar në institucionet qenësore politike, siç janë pozita e Kryeministrit, MPB dhe Ministria e FSK, përderisa LDK kishte mbajtur MD-në.

Deklarata e pavarësisë kishte kaluar me më pak incidente se sa ishte pritur, duke llogaritur rreziqet dhe kërcënimet politike që potencialisht i kanoseshin Kosovës për shkak të kundërshtimeve të shtetësisë së saj nga qarqet e ndryshme. Përpjekjet e zyrtarëve të Beogradit që të bllokojnë procesin e njohjes kanë pasur ndikim si në zhvillimet socio-politike po ashtu edhe në ato të sigurisë. Në veçanti, ndërmarrja e fushatave diplomatike ishte sfidë serioze, ndërsa përpjekjet për të fituar anëtarësimin në organizata ndërkombëtare si OKB, etj. Ishin paralizuar, për shkak të vetos së Rusisë dhe kundërshtarëve të tjerë.

## **Analiza Institucionale**

Vlerësimi i institucioneve të sigurisë në periudhat e pas-konfliktit reflekton pozicionimin e tyre në kushtetutë si dhe shfaqjen e mekanizmave të ri të sigurisë. Në fakt, roli i strukturave lokale të sigurisë ishte fuqizuar, edhe pse në një masë ndikimi i trupave ndërkombëtare të pranishëm në Kosovë nuk duhet nënvlerësuar. Pra kjo periudhë në njërin anë shënon performancën e ushtrimit të pushtetit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Policisë së Kosovës (PK) ndërsa në anën tjetër shënon rolin e rëndësishëm të EULEX dhe KFOR. Nuk mund të përjashtohet as roli i Këshillit të Sigurisë së Kosovës si organ konsultativ dhe koordinues. Mirëpo, ky hulumtim nuk ka për qëllim primar që të adresojë në mënyrë specifike rolin e saj.

## **Policia e Kosovës**

Shërbimi ekzistues Policor i Kosovës filloi të ushtroj detyra të reja, ndërsa struktura iu nënshtrua ndryshimeve përfshirë këtu edhe modifikimi i emrit në Polica e Kosovës (PK) i cili rrjedhë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Ligji i ri mbi Policinë, i cili hyri në fuqi në mes të vitit 2008, vuri në pah nevojën për reformim të strukturave policore. Para së gjithash, ligji siguroi vendosjen e kontrollit civil mbi policinë – e cila duhet udhëhequr dhe menaxhuar nga MOLA. Kjo ka orientuar zyrtarët drejtues të policisë drejt arritjes së standardeve evropiane, si dhe ka siguruar zinxhir të qartë komandues dhe në mënyrë specifike ka adresuar funksionimin e stacioneve lokale të policisë në komunat kryesisht



të banuara nga komunitetet minoritare (Ligji mbi Policinë e Kosovës, 2008). Nevoja për ndryshime rrënjësore këtë fazë e bënë një nga periudhat më të rëndësishme të reformimit të PK që prej kohës së ekzistimit të saj, si dhe ka paralajmëruar përfshirjen e shoqërisë civile në kontrollin demokratik të këtij institucioni.

Nisur nga një shikim i përgjithshëm i situatës aktuale, Policia e Kosovës është duke u përballur më vështirësi të ndryshme, përfshirë këtu: vështirësitë funksionale dhe problemet organizative; bashkëpunimin e zbehtë me Gjykatat Penale dhe bashkëpunim jo të qëndrueshëm ndërkombëtar (përfshirë këtu bashkëpunimin me policinë e shteteve fqinje); ri-integrimin e komunitetit serb; e kështu më radhë. Vështirësitë funksionale dhe organizative në PK janë si rrjedhojë e të qenit institucion relativisht i ri. Përndryshe, pavarësisht prej progresit në ndërtimin e strukturës policore dhe tentimeve të vazhdueshme për reforma, reputacioni i PK është formësuar nga një mori ngjarjesh. Prej tyre, vlen të përmendet edhe 'vjedhjen' që ndodhi në ndërtesën kryesore të PK në Prill të vitit 2009, ku një numër i konsiderueshëm i armëve, drogës dhe dokumenteve të rëndësishme në një vlerë prej mbi një milion eurosh ishin zhdukur në mënyrë të mistershme. Ngjajshëm, edhe ngjarjet në pjesën veriore të Kosovës kishin shpalosur disa mangësi në kuptim të komandës dhe kontrollit, ndërsa zinxhiri komandues duket të ketë qenë krejtësisht jo funksional,<sup>20</sup> duke shkaktuar reagime të ndryshme në opinionin e gjerë publik.

Bashkëpunimi ndërkombëtar mbetet gjithashtu sfidë për PK, pasi që qasja e këtij institucioni ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar në masë të madhe është e varur nga dimensionin politik, duke e bërë mjaft problematik progresin në këtë fushë. Megjithatë përvoja ka treguar se mund të arrihet një nivel i shkëlqyeshëm i bashkëpunimit të PK me policinë e vendeve fqinje si ajo e Shqipërisë, Malit të Zi, dhe Maqedonisë. Megjithatë, mungon bashkëpunimi zyrtar me Policinë e Serbisë për shkak të qëndrimit të saj kundërshtues ndaj pavarësisë së Kosovës.<sup>21</sup> Kjo paraqet sfidë veçanërisht në çështjet e ndërlidhura me Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) duke pasur parasysh që Kosova ndanë përafërsisht 350 km të vijës kufitare me Serbinë nga gjithsej 740 km ( Strategjia e MIK, 2009: 5). Gjithashtu duhet theksuar që mungesa e bashkëpunimit me Policinë e Serbisë sfidon bashkëpunimin e përgjithshëm rajonal.

### **Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK)**

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) i takon grupit të të institucioneve të krijuar pas pavarësisë. Edhe pse FSK ka një mision civil të ngjashëm më ish Trupat Mbrojtëse të Kosovës,

<sup>20</sup> Në shumicën e rasteve pjesëtarët serb në PK të cilët veprojnë në Veri të Kosovës kanë refuzuar t'i nënshtrohen urdhrave nga Prishtina për sa i përket disa rasteve të veçanta

<sup>21</sup> Ka indikacione në lidhje me bashkëpunimin ndër-politor me Serbinë, megjithatë kjo vlen vetëm për nivelin operacional



zyrtarisht nuk ka ndonjë kontinuitet ndërmjet këtyre dy institucioneve. Në fakt, TMK ishte shpërbërë ka fundi i vitit 2008 pasi misioni i saj u konsiderua të ishte përmbushur edhe pse është vlerësuar se përafërsisht 50% e ish pjesëtarëve të TMK-së ishin përzgjedhur për të shërbyer në FSK (Kosova press, 2009). Edhe pse fillimisht e dizajnuar vetëm për ushtrimin e funksioneve të operacioneve mbrojtjes civile, sikurse janë ato të dhënies së ndihmesës autoriteteve civile në rast të reagimit ndaj emergjencave natyrore dhe tjera, FSK ka për mision të ndërtoj kapacitetet e saja, bazuar në standardet e NATO-s (Forca e Sigurisë së Kosovës, 2009). Koncepti themelor i formimit të saj i referohet një 'force shumë etnike të armatosur lehtë e cila do të dizajnohet dhe përgatitet që të përmbush funksionet tjera të sigurisë, të cilat nuk janë adekuate për polici apo organizata tjera të zbatimit të ligjit '(Ahtisaari Proposal 2007).

Struktura e FSK-së me shumë konsiderohet unike krahasuar me institucionet tjera të ngjashme në vendet tjera në rajon. Procesi i ndërtimit të strukturave të FSK është ende në zhvillim, ndërsa krijimi i Ministrisë së FSK (MFSK) identifikon hapin e parë në drejtim të krijimit të strukturave të saj. Struktura bazë e FSK-së do të përbëhet nga 2,500 pjesëtarë të rregullt dhe 800 rezervë të cilët do të mbajnë uniforma, emblemë dhe do të armatosen lehtë. Edhe pse procesi i përzgjedhjes ka qenë rreptësisht i mbikëqyrur dhe i intensifikuar, prapë se prapë është përballur me kundërthënie dhe kundërshtime. Në mesin e grupeve të pakënaqura për sa i përket përzgjedhjes së rekruteve të parë të FSK-së kishte edhe pjesëtarë të TMK, shumë prej të cilëve dështuan ti kalonin testet, gjë që shkoi në favor të rekrutëve më me pak përvojë. Për më shumë, një prej sfidave kryesore në aspektin e ndërtimit të strukturave të FSK-së ishte përfshirja e minoriteteve në rekrutim, e në veçanti të komunitetit serb.

Një numër i vogël i personelit, i armatosur lehtë dhe me armatim të kalibrit të vogël, me objektiva të kufizuara dhe nën mbikëqyrje të pranisë së NATO/KFOR në Kosovë janë indikator që FSK është duke u zhvilluar në strukturë e cila gjeneron siguri në rajon. Në të vërtetë, nuk ka ndonjë pritje që roli i FSK të mund të modifikohet në pesë vitet e ardhshme, duke qenë se Ligji për KSF në mënyrë eksplicite parasheh që, "Një rishikim i plotë i këtyre përkufizimeve do të ndërmerret jo më herët se 5 vite nga data e hyrjes në fuqi e këtij Ligji" (Ligji për KSF: Art 10.2)

Kontrolli civil dhe demokratik është çështje shumë e rëndësishme në zhvillimet e FSK. Komisioni i veçantë për mbikëqyrje parlamentare të FSK-së ishte themeluar por është e vështirë të vlerësohet efikasiteti i komisionit, duke qenë se ende është në fazën e hershme të konsolidimit. Për më shumë, përfshirja e shoqërisë civile dhe e mediave në zhvillimet e FSK deri më tani konsiderohet të jetë mjaft i kufizuar.



## **EULEX**

Periudha e pas pavarësisë thekson nevojën e vendosjes së Misionit të EULEX, i cili është konsideruar gjerësisht si misioni më i madh civil i BE-së i ndërmarrur në fushën sundimit të rendit dhe ligjit. Ky mision synon të monitoroj, mentoroj dhe këshilloj (MMK) policinë, gjyqësorin dhe doganën e për qëllim kryesor ka arritjen e standardeve evropiane në proceset integruese në BE. Megjithatë, prezenca e EULEX-it në Kosovë synohet të jetë shumë më pasive se ajo e UNMIK-ut, duke mos pasur qëllim qeverisjen e vendit, por me synim të forcimit të institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë nga e cila do të përfitonin të gjithë qytetarët e saj (ALSAT 2009). EULEX ka të rezervuara disa fuqi ekzekutive të cilat mund ti përdor në raste të veçanta në luftimin e krimit të organizuar dhe ndjekjen e të dyshuarve për krimet e luftes (EULEX 2009). Ky mision gjithashtu ofron ndihmë, në vlerësimin e sistemeve dhe strukturave aktuale si dhe të identifikoj fushat të cilat kërkojnë zhvillim dhe reforma në të ardhmen.

Synimi i EULEX-it në lidhje me misionin e saj për MMK ka qenë që të ndihmojë PK dhe nën moton e re për "operacionalizim lokal" është pranuar që PK do të udhëheq dhe jo EULEX ashtu sikurse edhe kishte ndodhur me misionin e EULEX. Përderisa situata e sigurisë gëzon një përmirësim të ndjeshëm. Sfidë për sektori i sigurisë në Kosovë akoma mbeten krimi i organizuar dhe korrupsioni shumë i madh. Në këtë aspekt, qëllimi primar i EULEX ka qenë ofrimi i ndihmës në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dukuri të cilat shpesh bashkëveprojnë.

Megjithatë Policia e Kosovës ende gjendet në proces të reformimit të saj, në mënyrë që të qrrënjoset rreziku që i kanoset nga korrupsioni dhe futja e elementeve të krimit të organizuar brenda strukturave të saj, ndonëse në fakt policia shihet si një nga shtyllat më efektive sa i përket sektorit të sigurisë (Dagand, 2008: 38). EULEX do të përballet me sfida të mëdha në eliminimin e mangësive në sektorin e drejtësisë në vend. Andaj përpjekjet në të ardhmen duhet të koncentrohen në ndihmësen e dhënë institucioneve lokale për të krijuar sistem ligjor adekuat dhe drejtësi e cila do të jetë në mbështetje të luftimit të korrupsionit dhe të shërbejë për të garantuar siguri dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët e Kosovës.

### **Prezenca Ndërkombëtare Ushtarake**

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008, KFOR ka marrë rol të ri, duke ndihmuar në shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe themelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), si dhe strukturën e mbikëqyrjes civile të saj. Ndryshimet e ndodhura në misionin e KFOR-it në Kosovë vërehen edhe me reduktimin drastik të numrit të trupave i cili pritet të filloj në vitin 2010 ku deri më vitin 2011 priten të mbeten vetëm 2,500 trupa (NATO –KFOR 2009). Krerët e shteteve të NATO-s kanë theksuar që NATO qëndron e gatshme që të luajë rolin e saj në zbatimin e marrëveshjeve të ardhshme të sigurisë (Deklarata nga Samiti i Bukureshtit, 2008). Në fakt, normalizimi i situatës së sigurisë e ka bërë më solide prezencën e KFOR-it në aspektin psikologjik se sa në atë fizik.



Pavarësisht prej disa dështimeve të theksuara operacionale, prezenca e KFOR-it ka qenë thelbësore në mirëmbajtjen dhe ofrimin e sigurisë për gjithë qytetarët dhe komunitetet në Kosovë. Kjo ka reflektuar në ndërtimin e nivelit të lartë të besueshmëris dhe kredibilitetit tek publiku i gjerë— si diçka jo edhe aq e zakonshme për shumicën e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare që operojnë në Kosovë. Sipas Raportit të Vlerësimit të Hershëm të UNDP, KFOR kishte kryesuar vlerësimet e opinionit publik në Kosovë si institucioni me i besuar, me gjithsejt 80-90% qytetarëve që kan shprehur pikpamje pozitive për këtë forcë gjatë 4 vitet e fundit. (UNDP Kosovë, 2008).

## PËRFUNDIMET

Krahasuar me proceset e RSS me vendet në rajon, cikli i zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë është unik. Institucionet bazë të sigurisë kanë filluar të ndërtohen nga zeroja dhe nuk kanë pasur asnjë lidhje institucionale me sistemet e para konfliktit. Megjithatë, kufizimet kryesore lidhur me kompletimin e sektorit të sigurisë, kishin të bënin me zhvillimin e përgjithshëm politik të fatit të Kosovës. Dizajni i saj u mbështet kryesisht në negociatat politike për statusin e Kosovës dhe rezultatin e tyre. Kështu, u deshën nëntë vite për të kompletuar sektorin e sigurisë dhe për të kompletuar atë me kornizen ligjore.

Mungesa e pronësisë lokale është një çështje shqetësuese në zhvillimet e përgjithshme të sektorit të sigurisë. Ky hulumtim nuk mund të trajtojë në detaje pasojat e dalanga ndikueshmëria llojeve të ndryshme të modeleve të jashtme në ndërtim të sektorit të sigurisë, edhe pse vërehet gjerësisht mungesa e kontekstit lokal gjatë zhvillimit institucional të mekanizmave të sigurisë e cila mund të korrespondojë në mospërputhje me nevojat lokale. Periudha e parë dhe e dytë theksojnë sektorin e sigurisë të drejtuar ekskluzivisht nga ndërkombëtarët.

Zhvillimi i mbikqyrjes demokratike- Mbikëqyrja në periudhën e parë dhe të dytë vazhdimisht ishte penguar si rezultat i kompetencave ekskluzive të PSSP-së së UNMIK-ut. Mbikëqyrja parlamentare filloi të konsolidohet në të njëjtin ritëm me krijimin e institucioneve gjatë periudhës pas shpalljes së pavarësisë. Megjithatë performanca e këtij kontrolli nuk është e mundur të vlerësohet në kuadër të këtij vlersimi për shkak se për një gjë të tillë kërkohet të zhvillohet hulumtim i veçantë.

Së fundi, roli i paritve politike, veçanarisht atyre që dolën nga ish-luftetarët ishte dominant. Tendanca për të mbajtur pozitat kyçe në siguri brenda qeverisë konfirmon dëshirën politike të disa partive të caktuara politike për të mbajtur kontrollin në institucionet e sigurisë. Përveç kësaj, ndërlidhja dhe përkatësia politike me shërbime të caktuara inteligjente në disa raste ishte dëshmuar.



## ANEXI I AKTERËVE KRYESORË OLITIK

Emri i Aktorit: Partia Demokratike e Kosovës (Shqip: Partia Demokratike e Kosovës – PDK)			
Profili	Vizioni	Strategjia	Kapacitetet
<p>Partia politike ka dal nga ish anëtarët e UCK-së</p> <p>E ndërlidhur me ish anëtarët e krahut të luftës</p> <p>Aktualisht parti në koalicion dhe parti më e madhe në Kosovë</p>	<p>E pa profilizuar, dhe si shumica e partive në Kosovë, ata pretendojnë të jenë parti e qendrës.</p> <p>Vizioni i tyre është të arrijë standardet politike dhe ekonomike si dhe të krijoj barazi për të gjitha komunitet</p>	<p>Qëllimet e saj janë të vazhdoj të mbetet parti udhëheqëse si dhe parti kryesore qeverisëse në Kosovë.</p> <p>Vazhdimësia e rolit dominant në proceset vendimmarrëse</p> <p>Të përdor mjete demokratike dhe paqësore por të kritikua nga bashkësia ndërkombëtare për faktin se synon të kontrolloj më mënyre rigorozë aparatit shtetëror.</p>	<p>E themeluar më 1999 nga zyrtarët kryesor të drejtorisë politike të UCK-së.</p> <p>2000-2007 partia kryesore opozitare. Që nga 2007 deri më tani, PDK është bërë partia kryesore udhëheqëse, duke mbajtur pozitën e kryeministrit dhe kryesuesit e Kuvendit të Kosovës.</p> <p>Ka udhëhequr procesin e shpalljes së pavarësisë në 2008</p> <p>E përfshirë në të gjitha proceset e zhvillimit dhe reformës së sektorit të sigurisë në Kosovë.</p>



Emri i Akterit: Lidhja Demokratike e Kosovës (Shqip: Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK)			
Profili	Vizioni	Strategjia	Kapaciteti
Partia e parë politike post-socialiste në Kosovë e themeluar më 1989  E ndërlidhur me figurën e Dr. Ibrahim Rugova  Aktualisht parti në koalicion si parti e dyte më e madhe në Kosovë	Ende e pa profilizuar edhe pse pretendon t'i takoj qendrës së djathtë.  Me xhelozë përcjellë të ashtu-quajturën "Filozofi Rugovianë"  Për një kohë, e prirë për rezistencë paqësore	Ri-pozicionimi i LDK-së si parti politike më e madhe  Vazhdon rolin e saj dominues në procesin e vendimmarrjes  Shfrytëzon mjetet demokratike dhe paqësore  Përcjellë trashëgiminë e ish-presidentit Rugova	Që nga 1989 – 1999 LDK ishte e ndërlidhur me lëvizjen paqësore, me qëllim zgjidhjen e statusit final të Kosovës paqësisht  Ka themeluar dhe drejtuar institucionet paralele gjatë regjimit të Millosheviqit.  2000 – 2007 parti dominante në pushtet  Që nga 2002 ka mbajtur pozitën e Presidentit të Kosovës
Emri i Akterit: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (Shqip: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – AAK)			
Profili	Vizioni	Strategjia	Kapaciteti
Parti politike e dalë nga ish pjesëtarët e UCK-së  E ndërlidhur me individ të krahut të luftës  Aktualisht parti e pestë më e madhe parti e tretë opozitare,	Ende e pa profilizuar, edhe pse shumica e partive në Kosovë pretendojnë të jenë parti të qendrës.  Për një kohë, e ndërlidhur me rezistencën e pas-armatosur.  Vizioni i tyre është të arrijë standard ekonomike dhe politike si dhe të krijoj barazi për të gjitha komunitetet.  Elidhur ngushtë me figurën Ramush Haradinaj (ish gjeneral në UCK-së dhe ish kryeministër i Kosovës) i cili është përballë me gjyqin nga 2005-2008, ndërsa pas lirimit të tij, apeli i prokurorisë mbizotëroi duke filluar kështu ri-gjykimin me 2010	Qëllimi i saj është të kthehet në parti kryesore politike dhe të rikthejë rolin e saj në institucionet qendrore.  Synon kthimin e saj dominues në proceset vendimmarrëse  Shfrytëzon mjete demokratike dhe paqësore  Raportet e tensionuara me PDK, dhe për momentin parti politike më aktive në opozite.	E themeluar më 1999 nga ish ushtarët e UCK-së, shumica e tyre nga regjioni i Dukagjinit.  2000 – 2007 ishte parti kryesore politike nga 2003, ishte në pushtet nga 2003, ishte në pushtet me LDK.  Arritja e pozitës së kryeministrit deri me zgjedhjet e vitit 2007.





Emri i Akterit: Shoqata e Veteranave të Luftës (KLA) Veteranet e UCK-së			
Profili	Vizioni	Strategjia	Kapaciteti
Aktor jo statutor i sigurisë  Ish anëtarë të UCK-së  Ka prezence në mbarë botën	Mbrojtja e vlerave të luftës së UCK  Avokimi për interesa të shqiptarëve të Kosovës.	Lobimi për përmirësimin të statusit të tyre si një pjesë e rëndësishme e shoqërisë së Kosovës.	E themeluar më 1999 nga strukturat e shpërbëra të UCK-së  Ndikuese në periudhën e pas-konfliktit veçanërisht në çështjet që konsiderohen të 'rëndësishme strategjike'  Aftësia për të ndikuar disa vendime
Emri i akterit: Shërbimi Informativ i Kosovës (Shërbimi Informativ i Kosovës – SHIK)			
Profili	Vizioni	Strategjia	Kapaciteti
Aktor jo statutor i sigurisë  E krijuar gjatë periudhës së rezistencës së UCK-së si shërbim i inteligjencës dhe kundër-inteligjencës  Pas 1999 e lidhur fort me PDK	Mbledhja e informacionit, meshumë gjasë për qëllime të disa grupeve të caktuara dhe individëve.  Performimi për 'të mirën publike dhe kombëtare'	Ndërmarrja e misioneve sekrete  Analiza e kërcënimeve dhe rreziqeve	E themeluar nga 1999 nga ish shpërbëria e UCK-së  Nga 15 qershori i 2008 formalisht ka përfunduar së ekzistuar edhe pse besohet që disa prej ish anëtarëve të saj ishin përfshirë në struktura qeveritare.
Emri i akterit: Shërbimi Informativ i Kosovës (Shërbimi Informativ i Kosovës – SHIK)			
Profili	Vizioni	Strategjia	Kapacitetet
E krijuar nga figura e Albin Kurtit  Lëvizje jo-qeveritare	Lëvizja vet-vendosje e Kosovës  Pronësi lokale për procese vendimmarrëse në Kosovë	Protestimi kundër dominimit të organizatave ndërkombëtare për rolin kryesor vendimmarrës në Kosovë  Kundërshtimi i Propozimit të Ahtiar-it	Kundërshtimi i vendimeve kryesore politike dhe mobilizimi i një pjesë të shoqërisë kundër 'zgjidhjeve të imponuara ndërkombëtare' si dhe i negociatave me Serbi  Një prej lëvizjeve që në vazhdimësi kundërshton ish UNMIK-un dhe aktualisht misionin e EULEX-it.





Emri i Akterit: Strukturat Paralele në hapësirat me popullate Serbe			
Profili	Vizioni	Strategjia	Kapaciteti
<p>Akter jo statutor</p> <p>E kompozuar nga figurat politike Serbe në veri të Mitrovicës</p> <p>Besohet që përkrahet nga Beogradi zyrtar</p> <p>Gjeografikisht, prezence e theksuar në veri të Kosovës, por edhe në pjesët qendrore (hapësirat e populluara nga Serbet)</p>	<p>Ofron shërbime publike për Serbet si dhe komunitetet tjera që jetojnë në Kosovë</p> <p>Kundërshton institucionet e përkohshme të vet-qeverisjes si dhe institucionet e pas-pavarësisë</p>	<p>influence e madhe mbi Serbet që jetojnë në Kosovë</p> <p>Bojkotimi i përfshirjes së komunitetit Serb në institucionet e Kosovës.</p> <p>Struktura të forta paralele sikurse; sistemi i shëndetësisë, edukimit, i drejtësisë dhe rendit publik.</p>	<p>Kundërshtimi me të gjitha mjetet i proceseve në Kosovë.</p> <p>Ndikimi i shumicës së Serbeve në bojkotim të institucioneve të Kosovës.</p>
Emri i Akterit: Ambasadat e Huaja të Kosovës			
Profili	Përkrahja	Strategjitë	Kapacitetet
<p>Përfaqësimi diplomatik ndërkombëtar në Kosovë.</p>	<p>Përkrahja e institucioneve demokratike në Kosovë</p> <p>Ofrimi i ndihmës në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve dhe monitorimi</p> <p>Kontribut në krijimin e një ambient shumë-etnik për të gjitha komunitetet në Kosovë</p>	<p>Kontributi në procese paqësore</p>	<p>Aftësia për të ndikuar në procese qenësore politike</p> <p>Roli i fuqishëm në kontrollimin e ligjeve dhe strategjive</p>



Emri i Akterit: Organizata Ndërkombëtare			
Profili	Vizioni	Strategjitë	Kapacitetet
<p>EULEX – Mision I Sundimit të Ligjit I BE-së</p> <p>ICO – Zyra Ndërkombëtare Civile</p> <p>OSCE, USAID, UNDP, DFID</p>	<p>EULEX: Mentorimi, Mbikëqyrja dhe Këshillimi në polici, drejtësi dhe dogana. Mbajtja e kompetencave ekzekutive në lidhje me krimet e luftës dhe krimin e organizuar.</p> <p>ICO: Mbikëqyrje në lidhje me zbatimin e pakos së Ahtisarit</p> <p>Tjera: Koordinimi i Donatorëve – ndërtimi i kapaciteteve dhe përkrahja në demokratizimin e Kosovës.</p>	<p>Ndërtimi i kapaciteteve të qeverisë së Kosovës, dhe shoqërisë civile</p>	<p>Ndikimi i fuqishëm në vendimmarrje</p> <p>Ofrimi i fondeve në projekte</p> <p>Pjesëmarrja në procese kyçe politike</p>



## BIBLOGRAFIA

### Dokumentet Ligjore

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, 15 Qershor 2008 <<http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf>>
2. Korniza Kushtetuese e Kosovës, UNMIK, Gazeta Zyrtare, 2001
3. Ligji mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, 15 Qershor 2008
4. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 1244, 10 Qershor 1999
5. MoIA, Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufijve, Prill 2009
6. Ligji mbi Policinë e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, 15 Qershor 2008

### Raportet dhe Revistat

7. Ahtisaari, M., 2007, Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, [http://www.unosek.org/docref/Comprehensive\\_proposal-english.pdf](http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf)
8. Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese, Monitorimi i Gjykatave të Kosovës, Qershor 2009, Prishtinë
9. Bryden, A. & Hanggi, H., 2004, Reformimi dhe Rindërtimi i Sektorit të Sigurisë.
10. Dagand, S., 2008, Perspektivat për të Ardhmen e Kosovës: Roli i Reformës së Sektorit të Sigurisë, Rishikimi i Sigurisë Evropiane, ISIS Europe, 38.
11. E përditshmja "Express" Prill 2007
12. DCAF & UNDP, 2008, Mbikëqyrja Publike e Sektorit të Sigurisë, Doracak për Organizata të Shoqërisë Civile.
13. EULEX, Raport i Programit, Korrik 2009, <http://www.eulex-kosovo.eu/en/front/>
14. FRIDOM, Rishikimi Funkcional i Policisë së Kosovës, DFID Kosova, 2009
15. Human Rights Watch, Dështimi i Parandalimit të Dhunës Kundër-Etnike në Kosovë, Korrik 2004, Vol 16, No. 6
16. Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 2000, Çfarë ndodhi me UCK? Europe Report
17. Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 2005, Bashkimi i Ndarjes së Mitrovicës, Europe Report No. 165.
18. Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Prill 2004, Kolapsi në Kosovë, ICG Europe Report No. 155.
19. ISSR, 2006, Rishikimi Ndërkombëtar i Sektorit të Sigurisë, UNDP dhe Qeveria e Kosovës.
20. Kai Aide K, Raporti për Kosovë, 2005
21. KIPRED, Mapping out the current parliamentary oversight of the security sector in Kosovo, 2008
22. Kosova Press 2009



23. Qeveria e Kosovës,- Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufijve, Qershor 2009.
24. Forca e Sigurisë së Kosovës (KSF) – Broshurë Informative, MKSF, Faqe 3 [http://mksf-ks.org/repository/docs/information\\_booklet\\_joining\\_en.pdf](http://mksf-ks.org/repository/docs/information_booklet_joining_en.pdf)
25. Pettifer. J, July 2003, Trupat Mbrojtëse të Kosovës në Tranzivion, Qendra Hulumtuese për Studime të Konfliktive, UK.
26. Qehaja R, 2004, Çështjet e sigurisë nacionale të Kosovës, [National Security Issues of Kosovo], Vata, Kosova
27. UNDP, Raporti i Paralajmërimit të Hershëm, (Edicionet Raportuese nga Nëntori 2002 – Deri më Prill 2009) <http://www.ks.undp.org/?cid=2,4>
28. UNMIK, Shtylla e Policisë dhe Drejtësisë, Qershor 2004, [http://www.unmikonline.org/justice/documents/PillarI\\_Report\\_June04.pdf](http://www.unmikonline.org/justice/documents/PillarI_Report_June04.pdf)

#### **Deklaratat**

29. Deklarata e Samitit të Bukureshtit – Lëshuar nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive pjesëmarrës në takimin e Këshillit Veri Atlantik në Bukuresht, 3 Prill 2008 [http://www.nato.int/cps/en/natolive/official\\_texts\\_8443.htm?selectedLocale=en](http://www.nato.int/cps/en/natolive/official_texts_8443.htm?selectedLocale=en)
30. KCSS Observimi, Prezantimi i Z. Velizar Shalimanov, Ish Zëvendës Ministër i Mbrojtjes së Bullgarisë, në konferencën “Bashkëpunimit Regjional – Bazat e Sigurisë”, mbajtur në Prishtinë në Maj 2009
31. Deklaratë e Nicholas Burns, Zëvendës Sekretar i SHBA-ve, 2004

#### **Websites**

- 32. NATO** [http://www.nato.int/kfor/struktur/nations/placemap/kfor\\_placemat.pdf](http://www.nato.int/kfor/struktur/nations/placemap/kfor_placemat.pdf)
- 33. UNMIK** <http://www.unmikonline.org/justice/police.htm>
- 34. EULEX** <http://www.eulex-kosovo.eu/?id=9>
- 35. MFSK** <http://mksf-ks.org>
- 36. KOSOVAPRESS** <http://www.kosovapress.com/>



## ANNEX 1

# KRONOLOGJIA E REFORMIMIT TË SEKTORIT TË SIGURISË NË KOSOVË

Ky shkrim trajton ngjarjet politike dhe ato të sigurisë duke filluar nga qershori i vitit 1999 deri me qershor të vitit 2009. Siç do të shpjegohet më detajisht në kontekst analizë, cikli i Reformimit të Sektorit të Sigurisë në Kosovë (RSSK) është i ndarë në tri periudha:

- Periudha e parë-fillon nga viti 1999 - 2005 dhe i referohet kryesisht Ndërtimit të Sektorit të Sigurisë (NSS). Siç edhe ceket më poshtë në kronologji, në këtë periudhë përpjekjet kryesisht ishin të drejtuara drejt ndërtimit të institucioneve të sigurisë siç janë: Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) si dhe mekanizmat tjerë të rëndësishëm të sigurisë. Karakteristike për këtë periudhë është ndikimi i madh i faktorit ndërkombëtar i cili është i shprehur në rezervimin e kompetencave të PSSP-së ndër të tjerat edhe në fushën e sektorit të sigurisë. Në këtë periudhë vendorët kishin kompetenca mjaft të kufizuara.
- Periudha e dytë -filloi nga fundi i vitit 2005 dhe përfshin periudhën kohore deri në fillim të vitit 2008 . Kjo periudhë karakterizohet me fillimin e bartjes së kompetencave nga komuniteti ndërkombëtar tek ai vendor. Publikimi i Rishikimit i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë (RBSS) (nga UNDP dhe Qeveria e Kosovës) konsiderohet si kthesë drejt ndërtimit të arkitekturës së re të sigurisë në Kosovë dhe vlerësimit të gjendjës aktuale në sektorin e sigurisë. Përveç kësaj, në këtë periudhë krijua i MPB dhe MD-së si dhe kalimi e kompetencave të UNMIK-ut ministritë përkatëse, të cilat ishin rezultat i nevojës për RSS në Kosovë.
- Periudha e tretë lidhet me Deklaratën e Pavarësisë dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Krahas Kushtetutës në këtë periudhë janë nxjerrur edhe ligjet të cilat shërbyen si bazament për themelimin e institucioneve të reja të sigurisë si: FSK, KSK, AKI. Nga ana tjetër filloj edhe reformimi i institucioneve të sigurisë si PK dhe institucionet e gatishmërisë emergjente.

### 1999

- (Qershor) Nënshkruhet Marrëveshja e Kumanovës ndërmjet NATO-s dhe Republikës Federale të Jugosllavisë. Kjo marrëveshje teknike parashihte tërheqjen e ushtrisë, policisë dhe mekanizmave tjerë të sigurisë jugosllave nga territori i Kosovës. Përveç kësaj, kjo arrëveshje përcaktoi zonën tokësore të sigurisë 5km nga vija kufitare me Kosovën, si dhe zonën e hapësires ajrore të sigurisë 25 km nga kufiri me Kosovën.<sup>22</sup>

<sup>22</sup> Shih webfaqen e NATO <http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>



- Këshilli i Sigurimit të OKB-së miratoi rezoluten 1244<sup>23</sup> duke vendosur administratën civile (UNMIK) dhe praninë ushtarake ndërkombëtare (KFOR) në Kosovë.
- 50.000 trupa të KFOR-it hynë në Kosovë.
- Gjenerali Mike Jackson nga Britania e Madhe u emërua Komandanti i Parë i Përgjithshëm i KFOR-it në Kosovë. Ai shërbeu në këtë pozitë deri me 8 Tetor 1999.
- Kontigjenti rus nga BeH zbarkoi në Aeroportin e Prishtinës duke krijuar tensione të rënda mes NATO-s dhe Rusisë.<sup>24</sup>
- (Korrik) Sekretari i Përgjithshëm i KB Kofi Annan emëroi Bernard Kouchner në pozitën e Përfaqësuesit të parë special të KB dhe Shef të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.
- Qeveria e Përkohshme e Kosovës transferohet në Prishtinë. Kjo qeveri ishte shpërndarë pas themelimit të këshillit qeveritar.
- (Gusht) Policia e UNMIK-ut mori përsipër detyrat e sundimit të ligjit në Prishtinë.
- (Shtator) U nënshkrua Marrëveshja për demilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe transformimi e saj në Trupat Mbrojtëse të Kosovës ngandërmjet komandantit të KFOR-it (KOMKFOR) gjenerali Mike Jackson; drejtorit politik të UÇK-së, Hashim Thaçi; komandantit të NATO-s në Evropë gjenerali Wesley Clark dhe komandantit të UÇK-së, gjeneral Agim Çeku.
- OSBE-ja hapi Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës në Vushtrri
- (Tetor) TMK filloi të funksionojë duke pasur si detyrë fillestare mbrojtjen civile dhe përgjigjen ndaj emergjencave dhe katastrofave. Struktura e saj ishte: Shtabi i Përgjithshëm, 6 Zona Mbrojtëse (të cilat ishin të shpërndara në regjionet si: në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjiilan, Mitrovicë dhe Skenderaj) si dhe njësi tjera mbështetëse.
- (Tetor) Gjenerali gjerman Klaus Reinhardt u emërua komandant i ri i KFOR-it, duke pasuar gjeneralin Mike Jackson. Ai shërbeu në këtë pozitë deri më datën 18 Prill 2000.
- IOM inicoi programin riintegrues për ish-luftëtarët e UÇK-së. Të regjistruar në këtë program ishin rreth 18.000 ish-luftëtarë të UÇK-së.
- Filloi të operojë gjenerata e parë e Shërbimit Policor të Kosovës.
- (Nëntor) Konflikti në luginën e Preshevës solli pasoja edhe për Kosovë, ku më e theksuar ishte në pjesën lindore të saj.

## 2000

- (Shkurt) U themelua Akademia e Mbrojtjes e TMK si dhe njësitë tjera mbështetëse.
- PSSP-ja nënkroi udhëzimet administrative për emërimin e zyrtarëve të lartë të TMK-së.
- Trazirat që ndodhën në pjesën veriore të Mitrovicës rezultuan me fatkeqësi

<sup>23</sup> Rezoluta 1244 e KS të KB <http://www.unmikonline.org/press/reports/N9917289.pdf>

<sup>24</sup> Clark Wesley, Waging Modern War, fq.57



dhe dëme të mëdha. Protestat u zhvilluan në mënyrë të përsëritur si nga ana e shqiptarëve po ashtu edhe nga serbët.<sup>25</sup>

- (Prill) Administrata e UNMIK-ut filloi regjistrimin e popullsisë dhe lëshimin e dokumentave të para identifikuese.
- Në këtë periudhë shpërtheu konflikti në Maqedoni i cili gjithashtu kishte pasoja në Kosovë. Vija kufitare me Maqedoninë ishte jo e sigurtë. Kontrabandistët dhe refugjatët kalonin kufirin të pakontrolluar.
- Gjenerali spanjoli Juan Ortuño u emërua komandant i ri i KFOR-it, duke pasuar gjeneralin gjerman Klaus Reinhardt. Ai shërbeu në këtë pozitë deri me 16 tetor 2000.
- (Shtator) 13 të burgosur me dosje për vepra të rënda penale arritën të arratisen nga burgu i Mitrovicës.
- U zbulua një sasi e madhe armësh si dhe u kapën zyrtarë serb të MPB nga KFOR-i në Graçanicë .
- (Tetor) Gjenerali Italian Carlo Cabigiosu u emërua komandanti i ri i KFOR-it duke pasuar gjeneralin spanjoll Juan Ortuño. Ai shërbeu si komandant i KFOR-it deri me datën 6 Prill 2001.
- U organizuan zgjedhjet e para të lira në nivelin lokal. LDK në krye me Ibrahim Rugoven fitoi shumicën e komunave pasuar nga PDK në krye me Hashim Thaçin dhe AAK në krye me Ramush Haradinaj. Serbët refuzuan të marrin pjesë në zgjedhje.
- (Nëntor) Në mesin e disa departamenteve, UNMIK-u themeloi Departamentin për Siguri Publike dhe Gatishmëri Emergjente.<sup>26</sup>

## 2001

- (Janar) Sekretari i Përgjithshëm Kofi Anan emëroi social demokratin danez Hans Hækkerup pasues të Bernard Kushner në pozitën e PSSP-së.
- U shpërndanë dokumentet e para të udhëtimit të UNMIK-ut.<sup>27</sup>
- (Shkurt) U nënshkrua Marrëveshja midis RFJ-së dhe Maqedonisë për demarkacionin e kufirit. Qytetaret e Kosovës pretendonin se rreth 2500 ha ju pasuan Maqedonisë.
- (Mars) KOMKFOR-i lejoi zvogëlimin e zonës tokësore të sigurisë.
- (Prill) Gjenerali norvegjez Thorstein Skiaker u emërua komandant i ri i KFOR-it duke pasuar gjeneralin italian Carlo Cabigiosu. Ai shërbeu si komandant i KFOR-it deri më 3 Tetor 2001.
- Konfrontimet në mes të demonstruesve serbë dhe policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë rezultuan me disa zyrtarë policor të plagosur.

<sup>25</sup> <http://www.unmikonline.org/civpol/photos/covermriot210200.htm>

<sup>26</sup> Rregullorja e UNMIK-ut mbi themelimin e Departamentit për Siguri Civile dhe Gatishmëri Emergjente

<sup>27</sup> <http://www.unmikonline.org/press/press/pr481.html>



- (Maj) Hartohet si dhe miratohet Korniza Kushtetuese<sup>28</sup> duke i lënë prap kompetencat kryesore tek PSSP-ja e UNMIK-ut ashtu sikurse ishte paraparë edhe me Rezolutën 1244. Korniza Kushtetuese shërbeu si bazë për organizimin e zgjedhjeve të para të lira në nivel qendror që do të rezultonin më pas në konsolidimin për herë të parë të Kuvendit të Kosovës, Qeverinë e Kosovës dhe emërimit të Presidentit. Gjithashtu ajo parashikoi funksionalizimin e komunave.
- (Shtator) Departamenti për Gatishmëri Emergjente pushoj së ekzistuari.
- (Tetor), Gjenerali Francez Marcel Valentin u emërua komandant i ri i KFOR-it duke pasuar gjeneralin norvegjez Thorstein Skiake. Ai shërbeu si Komandant i KFOR-it deri me 4 Tetor 2002.
- (Nëntor) U mbajtën zgjedhjet e para të përgjithshme. LDK-ja fitoi pasuar nga PDK dhe AAK
- Hans Hackerup u emërua në pozitën e PSSP duke zëvendësuar Bernard Kuchner.

## 2002

- (Janar) Euro (€) u bë zyrtarisht monedha e përdorur në Kosovë. Euro zëvendësoi Marken Gjermane (DM) e cila ishte në përdorim zyrtar në Kosovë që pas vitit 1999. Edhe pse kjo monedhë ka hyrë në përdorim, Kosova nuk është emituese e saje dhe nuk është pjesë e Bankës Qendrore Evropiane në Frankfurt.
- Bëhet për herë të parë inagurimi i Kuvendit të Kosovës i cili përbëhej nga 120 deputetë. 100 vende u takojnin përfaqësuesve të zgjedhur nga populli, ndërsa 20 vendet e tjera ishin të rezervuara për komunitetet pakicë (10 për komunitetin Serbët ndërsa 10 tjera për komunitetet minoritare të tjera). Kryetari i parë i Kuvendit të Kosovës u emërua Nexhat Daci.
- Kuvendi i Kosovës votoi Ibrahim Rugoven president të parë të Kosovës të njohur ndërkombëtarisht.
- (Shkurt) Sekretari i Përgjithshëm Kofi Annan emëroi Michael Steiner si pausës të Hans Hackerup.
- (Mars) U krijua Qeveria e re e Kosovës dhe kryeministër i parë i saj ishte Bajram Rexhepi. Ishte qeveri e unitetit, duke përfshirë të trija partitë politike kryesore (LDK, PDK, AAK) gjë që krijoi klimë politike jo opozitare. Kjo qeveri kishte kompetenca të kufizuara dhe ishte përgjegjëse në disa fusha si financa, ekonomi, rini, sport, kulturë, arsim, bujqësi, mjedis etj. PSSP-së i mbetën kompetencat e rezervuara në sektorin e sigurisë si: SHPK (Policia e UNMIK-ut); TMK; Shërbimet Korrektuese; Drejtësia; Punët e Brendshme dhe të Jashtme, Menaxhimi Kufitar dhe Dogana; si dhe sfera të tjera të rëndësishme.
- (Prill) Një tërmet goditi pjesën lindore të Kosovës, i cili si epiqendër kishte qytetin e Gjilanit. Tërmeti ishte i shkallës 5,9° të Rihterit me ç'rast u shkaktuan dëme të konsiderueshme materiale.

<sup>28</sup> Shih Kornizen Kushtetuese [http://www.unmikonline.org/pub/misc/FrameworkPocket\\_ENG\\_Dec2002.pdf](http://www.unmikonline.org/pub/misc/FrameworkPocket_ENG_Dec2002.pdf)





- KFOR-i reduktoi trupat nga 50.000 në 39.000.<sup>29</sup>
- (Korrik) Ndodhi një fatkeqësi në Korporatën Elektrike të Kosovës (Kosova 'B'). Kosova "B" ishte furnizuesi kryesor me energji në KEK.
- (Tetor), Gjenerali Italian Fabio Mini u emërua komandant i ri i KFOR-it duke pasuar Gjeneralin Francez Marcel Valentin. Ai shërbeu si komandant i KFOR-it deri më 3 Tetor 2003.
- U organizuan zgjedhjet e dyta lokale. LDK-ja fitoi komunat kryesore e ndjekur nga PDK në vend të dytë dhe AAK partia e tretë.

## 2003

- (Qershor) u reduktuan trupat e KFOR-it në 26000 trupa.<sup>30</sup>
- (Gusht) Sekretari i përgjithshëm i KB Kofi Anan emëroi Harri Holkeri si pasues i Michael Steiner në pozitën e PSSP-së.
- U zhvilluan disa protesta të organizuara nga serbët, duke bllokuar rrugët kryesore siq janë ato Prishtinë – Shkup dhe Prishtinë – Gjilan.
- (Tetor) Gjenerali Gjerman Holger Kammerhoff u emërua komandant i ri i KFOR-it duke pasuar Gjeneralin Italian Fabio Mini. Ai shërbeu si komandant i KFOR-it deri më 1 Shtator 2004.
- Për herë të parë, zunë vend bisedimet e drejtpërdrejta mes lidërshiptarëve shqiptarë të Kosovës dhe atij serb.
- (Dhjetor) Bashkësia ndërkombëtare filloi me imponimin e të ashtu-quajturave "Standartet Para Statusit" të Kosovës.<sup>31</sup>
- Sërisht KFOR-i reduktoi trupat e saj në 17 500.<sup>32</sup>

## 2004

- (Mars) me 17 mars ndodhën trazirat e dhunshme. Epilogu i kësaj proteste ishte 18 qytetarë të vdekur dhe qindra të tjerë të plagosur.<sup>33</sup>
- NATO urgjentisht i dërgoi 2500 trupa për ti përforcuar forcat ekzistuese të KFOR-it.
- UNMIK-u publikoi "Planin për Zbatimin e Standarteve".
- (Prill) Hynë në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal dhe Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.
- (Qershor) Søren Jessen-Petersen u emërua në postin e PSSP duke mbajtur këtë pozitë deri në fund të Qershorit të vitit 2006. Ai pasoi Harri Holkerin.

<sup>29</sup> [http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_48818.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48818.htm)

<sup>30</sup> [http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_48818.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48818.htm)

<sup>31</sup> Shih përmbajtjen e plotë <http://www.unmikonline.org/standards/priorities.htm>

<sup>32</sup> [http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_48818.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48818.htm)

<sup>33</sup> Protestat filluan pas publikimit të një titulli nga ana e mediave me lajmin që tre fëmijë shqiptarë janë tërhequr në lumë. Njëri fëmijë që shpëtoi ka pohuar që ata janë sulmuar nga fshatarët serbë. Ekzagjerimi i mediave është vlerësuar si 'pikë kthyesë' për demonstratën e dhunshme në të gjithë Kosovën. Kjo rezultoi me zhvendosjen e refugjatëve, në veçanti të komunitetit serb. U shkatërruan një numër i pronave private dhe janë djegur disa kisha ortodokse të serbëve.



- (Gusht) Rapoti i publikuar nga i Dërguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Kai Eide argumentoi se politikat "Standardet para Statusit" kishte mungesë kredibiliteti dhe sugjeroi që politikat e standardeve duhet të jenë të bazuara në prioritetet që synojnë që të lehtësojë diskutimet e ardhshme të rregullta rreth statusit.
- (Shtator) Gjenerali Francez Yves de Kermabon u emërua Komandant i ri i KFOR-it duke pasuar Gjeneralin Gjerman Holger Kammerhoff. Ai shërbeu si komandant i KFOR-it deri më 1 Shtator 2005.
- (Nëntor) U zhvilluan zgjedhjet e reja parlamentare në Kosovë. LDK dhe AAK krijuan qeverinë duke lenë PDK e cila pozicionohej e dyta në opozitë.
- (Dhjetor) Ramush Haradinaj nga partia AAK emërohet Kryeministër i Kosovës. Z. Ibrahim Rugova ri-emërohet president e po ashtu Nexhat Daci, ri-emërohet Kryetar i Kuvendit.

## 2005

- (Mars) Gjykata Ndërkombëtare e Hagës për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi (GJNH) shpalli aktakuzën ndaj Ramush Haradinajt dhe dy bashkëluftëtarëve të tjerë, pak pas pranimit të pozitës së kryeministrit. Z. Haradinaj dha menjëherë pas pranimit të aktakuzës jep dorëheqje dhe dorëzohet pranë gjykatës në Hagë. Z. Bajram Kosumi nga AAK emërohet Kryeministër i ri Kosovës.<sup>34</sup>
- (Maj) Kai Eide u emërua në pozitën e të Dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për të rishikuar Zbatueshmërinë e Standardëve në Kosovë.
- (Shtator) Gjenerali Italian Giuseppe Valotto u emërua komandant i ri i KFOR-it duke pasuar Gjeneralin Francez Yves de Kermabon. Ai shërbeu si komandant i KFOR-it deri me 1 Shtator 2006.
- (Tetor) Kai Eide rekomandoi fillimin e negociatave për statusin përfundimtar të Kosovës.<sup>35</sup>
- (Nëntor) UNDP-ja në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, Qeverinë Britanike dhe aktorët tjerë filluan projektin për Rishikimin e Brendshëm të Sektorit të Sigurisë në Kosovë. (RBSS)
- Policia Kufitare u themelua si njësi e veçantë brenda Shërbimit Policor të Kosovës
- Për herë të parë, filloi debati mbi funksionimin e shërbimeve të fshehta të informacionit; SHIK-u i kontrolluar nga PDK dhe "Sigurimi i Atdheut" i kontrolluar nga LDK.
- Koffi Annan emëroi Martti Ahtisaarin në pozitën e të Dërguarit të Special për bisedimet rreth statusit.
- (Dhjetor) PSSP-ja nënshkroi Udhëzimet Administrative për krijimin e dyministrive, të reja të Qeverisë së Kosovës: Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë

<sup>34</sup> <http://www.icty.org/sid/8631>

<sup>35</sup> <http://www.unosek.org/docref/KaiEidereport.pdf>



e Drejtësisë. Ky ishte hapi i parë drejtë bartjes së kompetencave në sektorin e sigurisë dhe drejtësisë.

## 2006

- (Janar) Vdesë Presidenti i Kosovës, Dr, Ibrahim Rugova në moshën 61 vjeqare i cili më parë ishte i diagnostifikuar më parë me sëmundjen e kancerit në mushkëri. Mijëra qytetarë të Kosovës si dhe përfaqësues diplomatik ndërkombëtarë morrën pjesë në funeralin e tij. Menaxhimi me suksesshëm i gjendjes së krijuar gjat kësaj kohe ishte vlerësuar pozitivisht.
- Komandanti i gardës së TMK-së refuzoi t'i bindet urdhërit të TMK-së në angazhimin e Batalionit të Ceremonisë në ceremoninë mortore të Presidentit. Ky rast është cilësuar nga ana e mediave si i politizim i gardës së TMK-së.
- (Shkurt) Fatmir Sejdiu u emërua nga Kuvendi I Kosovës në pozitën e Presidentit.
- Nisin bisedimet e para rreth statusit të Kosovës nën patronatin e përfaqësuesit të OKB-së nis ndërmjet Beogradit dhe autoriteteve të Kosovës. Takimi i parë ishte zhvilluar në Vjenë.
- (Mars) Kryeministri Bajram Kosumi dha dorëheqje pas presioneve të bashkësisë ndërkombëtare. AAK-ja emëroi Agim Çekun kryeministër të ri të Kosovës. Në të njëjtën kohë edhe Kryetari i Kuvendit, Nexhat Daci jep dorëheqje dhe LDK bënë zëvendësimin e tij atë duke emëruar në pozitën e Kryetarit të Kuvendit deputetin tjetër nga radhët e saj Z. Kolë Berishën.
- Gjeneral Sylejman Selimi u emërua komandant i ri i TMK-së duke zëvendësuar Gjeneralin Agim Çeku.
- (Prill) Bashkimi Evropian vendosi në Kosovë Misionin e Ekipit Planifikues të BE-së.
- Publikohet dhe shpërndahet raporti "Rregullimi i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë (i njohur si ISSR)
- (Qershor) NATO-ja riorganizon misionin e brigadave shumëkombëshe të KFOR-it duke krijuar force shumëkombëshe me qëllim të rritjes së mobilitetit të trupave të saj.
- (Korrik) Themelohet Inspektorati Policor i Kosovës. Ai themelohet si agjencion i pavarur ekzekutiv në kuadër të MPB-së.
- Qeveria themelon Agjencisë Kundër Korrupsionit. Kjo agjenci vepron si e pavarur nga qeveria dhe i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Drejtor i kësaj Agjencie u emërua Hasan Preteni.
- (Shtator) gjenerali Gjerman Roland Kather u emërua komandant i KFOR-it duke zëvendësuar Gjeneralin Italian Giuseppe Valotto. Ai shërbeu në këtë pozitë deri më datën 31 Gusht 2007.
- Komisioni Parlamentar për Gatishmëri Emergjente është transformua në Komisionin për Siguri.

**2007**

- (Shkurt) Në Prishtinë u organizuan demonstratat e dhunshme nga Lëvizja “Vetvendosje” me të cilat kundërshtohen negociatat për statusin e Kosovës. Dy demonstrues humbën jetën pasi që u qëlluan me plumba gome nga policia e UNMIK-ut ndërsa shumë të tjerë u plagosën rëndë.
- (Mars) Pas negociatave maratonike, i dërguari i posaçëm i OKB-së, Marti Ahtisaari publikoi planin e tij duke rekomanduar pavarësi të mbikqyrur për Kosovën. Sa i përket sektorit të sigurisë në këtë plan parashihej themelimi i Forces së Sigurisë së Kosovës (FSK), Agjencisë Kosovare për Inteligjencë (AKI), Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe Autoriteti i Aviacionit Civil. Përveç kësaj, ky plan parashihte reformimin e Policisë së Kosovës. Ky dokument po ashtu saktëson se çdo ndryshim i mëtutjeshëm në këtë sektor mund të ndodh vetëm pas 5 vjetësh të hyrjes në fuqi të këtij Plani.
- (Prill) Misioni i OKB-së për vlerësimin e gjendjes në Kosovë vizitoi Prishtinën dhe Beogradin për të vlerësuar përparimin e bërë.
- (Korrik) Zjarret mbulojnë të gjitha pyjet e Kosovës .
- (Gusht) Pesë të burgosur me dosje të larta kriminale u arratisën nga burgu i Dubravës.
- Gjenerali francez Xavier de Marnhac u emërua Gjenerali i ri i KFOR-it duke zëvendësuar Gjeneralin Gjerman Roland Kather. Ai shërbeu si komandant i KFOR-it deri me 29 gusht 2008.
- (Shtator) Joachim Rücker emërohet PSSP i ri, duke mbajtur postin deri me datën 15 Qershor 2008.
- (Nëntor) Mbahen zgjedhjet e reja parlamentare dhe lokale në Kosovë. PDK-ja arrin ti fiton zgjedhjet e ndjekur nga LDK dhe AKR.
- Vriten nga policia Maqedonase dy nga të arratisurit e fundit të burgut të Dubravës në një incident në fshatin Brodec.
- (Dhjetor) Formohet Qeveria e Re me Kryeministër Hashim Thaçi. Partnerë qeveritarë në këtë qeveri ishin PDK kryesuese e zhgjedhjeve dhe LDK si parti e dytë.

**2008**

- (Janar) Riemertohet Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme në emrin e ri “Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri”.
- (Shkurt) Kuvendi i Kosovës në unanimitet shpall Pavarësinë e Republikës së Kosovës. Ajo pranoi njohje të menjëhershme nga ShBA-ja, Shqipëria, Britania e Madhe, Afganistani dhe Turqia. Deri me sot Republika e Kosovës është njohur nga gjithsej 60 vende të botës.
- Digjen dy pikat e kalimit kufitar (pikat: 1 në Bërnjak dhe 31 në Jarinjë) nga demonstruesit serb. Pas kësaj ngjarje Policia e Kosovës dhe Dogana kontrollimin



- e mallërave që vijnë nga Serbia e bënë vetëm në pjesën jugore të Mitrovicës. Një gjendje e tillë ndikoi drejt rritjes së kontrabandës në pjesën veriore të Kosovës.
- Shpërthyen disa demonstrata të dhunshme në veri të Mitrovicës.
  - Zyrtarët policor të komunitetit Serb bojkotuan Policinë e Kosovës.
  - BE-ja themelon Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) i cili ka për qëllim ofrimin e mbështetjes së saj në fushën e sundimit të ligjit në Kosovës.
  - U krijua "Grupi Drejtues Ndërkombëtar" për Kosovën. Me ç'rast Peter Feith emërohet Shef i Zyrës Civile Ndërkombëtare në Kosovë.
  - (Mars) Kuvendi i Kosovës miratoi pakon e Ligjeve ashtu sikurse është paraparë sipas planit të Ahtisarit. Në këtë rast shumica e ligjeve të miratuara kishin të bënin me sektorin e sigurisë.
  - Presidenti Bush shprehimisht pohon se SHBA do të pajisë me armë Kosovën, duke aluduar në FSK-në.
  - UNMIK-u ri-mori kontrollin e një linjë hekurudhore në pjesën veriore të Kosovës e cila përdorej nga Serbia, për të dërguar dy nga trenat e saj në jug.
  - Serbët organizuan protesta të dhunshme në Mitrovicën Veriore duke pushtuar ndërtesën e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Një punonjës i Njësisë Speciale të Policisë së UNMIK-ut me nacionalitet Ukrainas humbi jetën nga një granatë dore e hedhur nga protestuesit Serb. Disa protestues u arrestuan.
  - Policia e UNMIK ut, e mbështetur nga paqëruajtësit francezë të NATO-s, ri-morrën ndërtesën e gjykatës.
  - (Prill) U nënshkrua Kushtetuta e Republikës së Kosovës nga deputetë e Kuvendit të Kosovës.
  - Qeveria e Kosovës themeloi Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ministër i saj u bë Skender Hyseni nga partia LDK.
  - (Qershor) Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyri në fuqi.
  - Në bazë të Ligjit të ri për Policinë, ndryshohet emërimi i Shërbimi Policor i Kosovës në "Policia e Kosovës". Po ashtu bëhet edhe ristrukturimi i policisë.
  - Qeveria e Kosovës mori nga UNMIK-u kompetencat mbi Doganën si rrjedhojë u emëruan Doganat e Kosovës.
  - Lamberto Zannier emërohet PSSP i radhës, post të cilin deri më tani e ushtron. Edhe pse roli i UNMIK-ut në Kosovë ishte reduktuar maksimalisht, drejtuesit e brendshëm të Kosovës kërkuan nga UNMIK-u që të largohet përfundimisht nga Kosova pasi që konsideronin qëllimet e këtij misioni tanimë janë realizuar.
  - Në takimin e Ministrave të Mbrojtjes së NATO-s, arrihet marrëveshja për fillimin e trajnimit të Forces së Sigurisë së Kosovës.
  - SHIK zyrtarisht deklarojnë së ky formacion pushon së ekzistuari.
  - Qeveria e Kosovës dhe Qeveria e Maqedonisë filluan procesin e demarkacionin të vijës kufitare midis dy vendeve.



- Zhvillohet stërvitja e përbashkët ndër-institucionale për reagim emergjent. TMK-ja kishte rolin drejtues ku ishin të përfshira palët kryesore.
- (Korrik) Ambasadat e para e Kosovës u hapën në nëntë shtete.
- Materiale të rrezikshme që vinin nga Irani hynë lirishëm në Kosovë. Reagime të forta kishte nga ana e popullsisë.
- Republika e Kosovës lëshoi pasaportat e para me logo të Republikës së Kosovës.
- (Gusht) Qeveria e Kosovës themeloi Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ministër u bë Fehmi Mujota nga PDK-ja.
- Gjenerali Italian Giuseppe Emilio Gay u emërua komandanti i KFOR-it duke zëvendësuar gjeneralin francez Xavier de Marnhac. Aktualisht ai është komandant i KFOR-it.
- (Tetor) Këshilli i Sigurisë i OKB-së votoi propozimin e qeverisë serbe për dhënjen e mendimit nga ana e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me ligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës.
- Maqedonia dhe Mali i Zi njohën pavarësinë e Kosovës.
- (Nëntor) Doganat e UNMIK-ut zyrtarisht u riemëruan Doganat e Kosovës.
- (Dhjetor) Misioni i EULEX-it filloi zyrtarisht misionin e tij në Kosovë pas dhënjes së miratimit nga Këshilli e Sigurimit të OKB-së.
- Presidenti i Kosovës emëroi gjeneralin Sulejman Selimi komandant të FSK-së.
- Kryeministri i Kosovës, emëroi Sheremet Ahmetin Drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës.
- Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës mori kontrollin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës.

## 2009

- (Janar) Shpërbëhet zyrtarisht TMK-ja. UNDP filloi programin ri-integrues të ish-pjesëtarëve të TMK-së që nuk janë pjesë e FSK-së. KFOR-i njoftoi që do të përfshihen rreth 1500 ish-anëtarë të TMK-së në FSK. Të tjerë anëtarë të FSK-së janë duke u rekrutuar me anë të të konkursit të hapur.
- Filloi funksionalizimi i FSK-ja. Kjo forcë në fillim pritet ti ketë 2500 trupa aktiv dhe 800 trupa rezervë. Detyrat fillestare do të jenë në fushën e mbrojtjes civile dhe ofrimi i ndihmës në sfera të cilat janë të pa-përshtatshme për policinë dhe praninë ushtarake ndërkombëtare në Kosovë. FSK po ashtu duhet përgaditur për misionet paqëeruajtëse ndërkombëtare.
- Është sulmuar Lokacioni i Brigadës së Tretë të Reagimit të Shpejtë në Pejë.
- (Shkurt) Presidenti i Kosovës dhe Kryeministri emëruan z. Bashkim Smakaj Drejtor të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.
- KFOR-i dhe Ministria e FSK-së shpallën konkursin për rekrutimin e pjestarëve të rinjë në Forcën e Sigurisë së Kosovës.
- KFOR filloi trajnimin e anëtarëve të FSK-së në Qendrën e Kosovës për Siguri



- Publike, Edukim dhe Zhvillim me seli në Vushtri.
- U zhvilluan demonstrata të dhunshme nga grupe të pakënaqura të pjesëtarëve të ish-TMK-së të cilet dyshojnë në mbarvajtjen e procesit i të përzgjedhjes së pjesëtarëve të rinjë të FSK-së.
  - Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës mbajti takimin e parë konstituiv të tij.
  - (Prill) MPB miratoi Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.
  - Ndodhi grabitje e rëndë në Selinë Qendrore të Policisë së Kosovës. Reaguan fuqishëm partitë opozitare dhe shoqëria civile.
  - Serbët e veriut të Mitrovicës protestojnë kundër ndërtimit të shtëpive të djegura në Kroin e Vitakut nga ana e Qeverisë së Kosovës për shqipëtarët e dëbuar nga pjesa e veriut.
  - (Maj) Mbajti takimin e dytë Këshilli i Sigurisë së Kosovës. Me këtë rast u inicua hartimi i Strategjisë Kombëtare të Sigurisë pas presioneve të vazhdueshme të shoqërisë civile për vonesën. Në këtë takim po ashtu u miratua logoja e KSK-së.
  - Kuvendi i Kosovës emëroi gjyqtarët vendor të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Në këtë gjykatë gjashtë gjyqtarë janë vendorë, ndërsa tre ndërkombëtarë.
  - Ministri i FSK-së njoftoi se Institucioni do të jetë gjysëm-operacional deri në shtator të vitit 2009.
  - MPB caktoi afatin e fundit (30 qershor) për zyrtarët policor të komuniteti serbë të Policisë të Kosovës të cilet e bojkotuan institucionin që shpallja e pavarësisë që të kthehen në vendet e tyre të punës. Ata kërcënohen nga kjo ministri se nëse nuk përgjigjen pozitivisht do të shpallet konkurs i ri për këto pozita në PK.
  - (Qershor) Kosova u pranua në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore.
  - NATO njoftoi që do të reduktojë gradualisht numrin e trupave të KFOR-it. Këtë vit trupat do të reduktohen deri në 10.000 ushtarë dhe deri në vitin 2011 numri i kësaj trupe do të bie në 2500.
  - Presidenti i Kosovës miratoi simbolet për njesitë e FSK-së.
  - Përfundoi trajnimet themelore gjenerata e parë e të rekrutuarve në FSK-së.

**Botuesi:**

*Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (KCSS)  
www.qkss.org*

*Rr. Qamil Hoxha 2-2, 10000 Prishtina, Kosovo  
Tel/Fax + 381 (0) 38 221 420  
E-mail: info@qkss.org*

**Autorët:**

*Florian Qehaja  
Mentor Vrajolli*

**Asistentë:**

*Skender Përteshi*

**Dizajni dhe layout:**

*Shpëtim Hoda  
Mentor Vrajolli*

**Edituan:**

*Suzana Anghel  
David Law  
Sonja Stojanovic  
Miroslav Hadzic*

**Lektorimi:**

*Ruchir Sharma*

**Përkthyer në shqip:**

*Fatmir Haxholli  
Sofije Kryeziu*

**Shtypi:**

*REFRESH, Prishtinë*

*Prishtina, 2011*

*ISBN 978-9951-8782-1-0  
Prishtina 2011*



Katalogimi në botim – **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

355.02(496.51) “1999/2009”(047)

Qehaja, Florian

Context Analysis of the Security Sektor Reform in  
Kosovo 1999-2009 / Florian Qehaja, Mentor Vrajolli.-  
Prishtina : Kosovar Centre for Security Studies, 2011.  
- 46 f. ; 30 cm.

1. Vrajolli, Mentor

**ISBN 978-9951-8782-1-0**



